



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 160 Akti

Nr. 166 Vendimi

Tiranë, më 21.6.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, në Tiranë, në datën 18.6.2019, ora 14:30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gurali Brahimllari**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, i përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 18.7.2018, të trupit gjykues nr.1, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, komisioner Roland Ilia. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Në datën 11.12.2018 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, në datën 12.12.2018 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 15.5.2019, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht që të paraqesë pretendime/sqarime shtesë, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 35 – 40 dhe 45 – 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
6. Në datën 15.5.2019 subjekti i rivlerësimit konfirmoi në rrugë elektronike njohjen me rezultatet e hetimit dhe, për arsye objektive (pune), kërkoi që afati 10 ditë për dërgimin e prapësimeve të fillonte prej datës 20.5.2019.
7. Në datën 17.5.2019 Komisioni i njoftoi subjektin të rivlerësimit në rrugë elektronike shtyrjen e afatit të depozitimit të prapësimeve, si dhe të dokumenteve provuese, sipas kërkesës së tij.
8. Në datën 27.5.2019 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sqarime mbi disa pika të rezultateve të hetimit, për të cilët Komisioni po në këtë datë, në rrugë elektronike, i ka dhënë informacionin përkatës.
9. Në datën 28.5.2019 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përsëri në rrugë elektronike sqarime mbi disa pika të rezultateve, për të cilët Komisioni, po në këtë datë, në rrugë elektronike, i ka dhënë informacionin përkatës.
10. Në datën 29.5.2019 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në rrugë elektronike vijimin e hetimit administrativ, marrjen e disa provave shkresore, të cilat i ka depozituar në këtë datë dhe në datën 30.5.2019, si dhe ka kërkuar thirrjen e disa shtetasve me cilësinë e dëshmitarëve.

11. Në datën 30.5.2019 trupi gjykues u mbledh për të diskutuar për kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për të cilën vendosi me vendim të ndërmjetëm: (i) pranimin dhe administrimin e provave shkresore të depozituara nga subjekti në rrugë elektronike dhe postare në datën 29 dhe 30 maj 2019; si dhe (ii) refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për thirrjen e shtetasve A. M., F. K., S. L., Q. L. dhe Th. F., me cilësinë e dëshmitarëve, pasi bazuar në germën “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, marrja e provës dukej e panevojshme, në kushtet që për këta shtetas subjekti depozitoi edhe dokumentacionin e hartuar dhe të nënshkruar prej tyre, si dhe dokumente të tjera mbështetëse. Vendimi i ndërmjetëm iu njoftua subjektit të rivlerësimit në rrugë elektronike, por edhe zyrtare nr. (***) prot. datë 30.5.2019.
12. Në datën 30.5.2019 subjekti i rivlerësimit, në rrugë elektronike, kërkoi shtyrje të afatit të depozitimit të prapësimeve deri në datën 7.6.2019 për arsye shëndetësore dhe për këtë depozitoi në rrugë elektronike raportin mjekësor, sipas të cilit konfirmohej se subjekti ishte i paafte për punë për periudhën 29.5.2019 – 1.6.2019.
13. Në datën 31.6.2019 trupi gjykues u mbledh për të diskutuar lidhur me kërkesën për shtyrje të afatit të dorëzimit të prapësimeve dhe pranoi kërkesën e subjektit për shtyrje të afatit të depozitimit të prapësimeve brenda datës 7.6.2019, për të cilën njoftoi edhe subjektin e rivlerësimit.
14. Në datën 8.6.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike, por edhe zyrtare, shpjegimet e tij, si dhe dokumentacionin shkresor, për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni në datën 15.5.2019.
15. Në datën 13.6.2019 trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 12.6.2019, vendosi të ftojë në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 18.6.2019, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.
16. Në datën 18.6.2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatit. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe për procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

Në përfundim të parashtrimeve subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 18.6.2019 për të rifilluar në datën 21.6.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Gurali Brahimllari ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. (***) , me shkresën nr. (***) , datë 10.5.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të justifikuar pasuritë deri në deklaratën para fillimit të detyrës, 2003;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1¹, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 30.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5² të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi 01370.

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur për çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse për të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe ta dërgojë atë pranë ILDKPKI-së.

² Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti interesash, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

❖ **Lidhur me pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 30.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016**

Komisioni ka vlerësuar që pasuritë në përmbajtje të këtij vendimi, të grupohen duke i kategorizuar veçmas pasuritë e krijuara përpara vitit 2003, veçmas pasurinë e fituar në vitet 2004 dhe 2005 dhe veçmas pasurinë e fituar në vitin 2008 e në vijim, për shkaqet dhe arsyet e përmendura më tej në arsyetimin e secilit grupim.

❖ Gjithashtu, Komisioni bën pjesë integrale të këtij vendimi edhe metodologjinë (ishte ANEKS nr.1), tek e cila janë bazuar konstatimet e rezultateve të hetimit administrativ për secilën pasuri. Kjo metodologji është pasuruar me të gjithë të dhënat e marra nga subjekti dhe është pranuar nga Komisioni për të kryer rillogaritje në analizën financiare.

➔ Në lidhje me pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga personat e lidhur me të përpara vitit 2003.

1. Në lidhje me pasurinë apartament, ndodhur në Rr. “(*)” (në fakt prej vitesh është përdorur për klinikë dentare, duke paguar detyrimet fiskale si njësi), nr. (***) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , me sip. 36 m², në vlerën 1.500.000 lekë, vërtetuar me certifikatën e datës 17.12.2014. Pjesa takuese: 100 %.**

1.1 Burimi i krijimit i deklaruar: të ardhura nga shitja e ½ pjesë e pasurisë ap. 1+1, nga bashkëshortja, L. B., në shumën 400.000 lekë, me kontratë nr. (***) , datë 9.8.1997 (e blerë në datën 21.12.1994 me kontratën nr. (***)), nga aktiviteti i saj si stomatologe në periudhën janar 1996 – dhjetor 1998, si dhe nga paga e subjektit si ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë.

1.2 Mënyra e fitimit të pasurisë: bashkimi i dy pasurive të deklaruara në ILDKPKI, në mars 2004:

✓ i pasurisë nr. (***) , z.k. (***) , sip. 20 m², blerë në datën 27 gusht 1997, me kontratë noteriale nr. (***) , në vlerën 7.000 USD, ose sipas kursit të këmbimit (USD = 1400 lekë) në vlerën rreth 980.000 lekë, e përbërë nga një dhomë, banjë dhe korridor, e ndodhur në Rr. “(***)” , pall. (***) , shk. (***) , ap. (***) , e regjistruar në datën 18.12.2002. Pjesa takuese: 50 %.

✓ i pasurisë nr. (***) , z.k. (***) , vol. (***) , f. (***) që vijon nga vol. (***) , f. (***) , sip. 16 m², regjistruar në datën 22.4.2009, pasuri e krijuar si shtesë anësore e pallatit ku gjendej pasuria e përshkruar më sipër, në vlerën 500.000 lekë (*sipas situacionit të firmës ndërtuese të shtesës*), ndërtuar me lejen e ndërtimit nr. (***) , datë 1.7.1998, e Bashkisë Tiranë, nga firma ndërtuese “G.” sh.p.k., me financim të pronarëve që përfitonin nga shtesa. Pjesa takuese: 50 %.

1.3 Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- certifikatë për vërtetim pronësie nr. (***) , datë 17.12.2014, për apartament me sip. 36 m², me nr. (***) , në pronësi të Gurali dhe L. B. ;
- kartelë pasurie e paluajtshme, apartament me sip. 36 m², rivlerësuar në datën 1.9.2011 në vlerën 7.056.500 lekë;

- deklaratë noteriale nr(***), datë 16.12.2014, nga Gurali dhe L. B. për bashkimin e pasurive nr. (***) dhe (***);
- kontratë shitblerjeje nr. (***), datë 27.8.1997, për pasurinë me apartament me një dhomë, banjë dhe korridor etj.

1.4 ILDKPKI-ja në konkluzionet e saj është shprehur: “*Subjekti nuk kishte paraqitur situacione ose preventive për shtesën e objektit me sip. 16 m², e ndërtuar me leje ndërtimi; se bashkëshortja e subjektit nuk justifikon me dokumentacion ligjor burimin e pjesës së vet takuese, të apartamentit me sip. 80 m² në Kuçovë, blerë në vitin 1994, me çmimin 875.000/2 = 437.500 lekë*”.

1.5 Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

1.5.1 ZVRPP-ja Tiranë³ ka konfirmuar se z. Gurali Brahimllari ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasuritë me të dhënat si më poshtë:

- Pasurinë apartament, me sip. 20 m², me nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), në bashkëpronësi me L. M. B. .
- Pasurinë apartament, me sip. 16 m², me nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***) .
- Pasurinë apartament, me sip. 36 m², me nr. (***), vol. (***), f. (***), z.k. (***), në bashkëpronësi me L. M. B. .

1.5.2 Kjo pasuri është deklaruar:

- Në vitin 2003, me burim krijimi kursimet nga të ardhurat e pagës së subjektit dhe të bashkëshortes së tij si stomatologe, **ndërsa** në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar edhe të ardhura nga shitja e 1/2 pjesë e pasurisë ap. 1+1, nga bashkëshortja e tij, në shumën 400.000 lekë, me kontratë nr. (***), datë 9.8.1997 (e blerë në datën 21.12.2004, me kontratë nr. (***).
- Komisioni, konstatoi mospërputhje në deklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi në vitin 2003 subjekti nuk i kishte deklaruar si burim krijimi të ardhurat e bashkëshortes në shumën 400.000 lekë, të krijuara nga shitja e 1/2 pjesë e pasurisë ap. 1+1, me kontratë nr. (***), datë 9.8.1997.

1.5.3 Komisioni, me pyetësin e datës 24.1.2019, e ka pyetur subjektin lidhur me këtë mospërputhje.

1.5.4 Në përgjigjen⁴ e dhënë, ndër të tjera, subjekti ka cituar shprehimisht: “... në burimin e të ardhurave për blerjen e pasurisë në vitin 1997... është përdorur edhe vlera prej 400.000 lekësh, e përfituar nga bashkëshortja në gusht 1997, për shitjen e pjesës 1/2 të apartamentit 80 m² (e blerë më parë prej saj me bashkëpronësi me të vëllanë, z. B. V., në datën 21.12.1994).”

1.5.5 Nga kontrata nr. (***), datë 9.8.1997, e administruar në praktikën e ZVRPP-së Kuçovë⁵, provohet shitja e 1/2 pjesë së pasurisë të apartamentit 1+1 nga bashkëshortja e subjektit te nëna e saj, në shumën 400.000 lekë.

1.6. Në vijim të hetimit për pasurinë e deklaruar në deklaratën “Vetting” nga dokumentacioni i ZVRPP-së Tiranë rezultoi se pasuria me sip. 20 m² e fituar prej vitit 1997, e përbërë nga një dhomë dhe një korridor, i ishte blerë në vlerën 7.000 USD shtetasit K. H., me kontratën nr. (***), datë 27.8.1997, në përmbajtje të të cilës thuhej shprehimisht se shuma ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale.

³ Shihni shkresën nr. (***) prot., datë 7.1.2019, dhe dokumentet bashkëngjitur saj, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni përgjigjen e pyetjes nr.1, të pyetësin datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 14.9.2017, në dosjen e ILDKPKI-së (aneksi 29).

1.7 Rezultoi se në këtë pasuri është ndërtuar shtesë me sip. 16 m², e përshkruar si pasuria me nr. (***) , bazuar në lejen e ndërtimit dhënë nga Bashkia Tiranë për të gjithë banorët e godinës, regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

1.8 Komisioni, nisur edhe nga konstatimi i ILDKPKI-së, se *subjekti nuk kishte paraqitur situacione ose preventive për shtesën e objektit me sip. 16 m², e ndërtuar me leje ndërtimi*, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin justifikues lidhur me ndërtimin e kësaj pasurie shtesë.

1.9 Subjekti depozitoi preventiv dhe katër situacione punimesh, të përgatitura nga shoqëria “G.” sh.p.k., dhe njëkohësisht sqaroi edhe mbi shpenzimet e kryera se duke iu referuar dokumentit aktkolaudim tekniko-ekonomik detyrimi i tij në ndërtimin e shtesës ka qenë rreth 200.772 (dyqind mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, ndërsa sipas ZVRPP-së në vlerën e pagesës 1% të pasurisë së rivlerësuar, rezulton se sipërfaqja 16 m² është llogaritur me çmimin total prej 530.752 (pesëqind e tridhjetë mijë e shtatë qind e pesëdhjetë e dy) lekësh (ose 33.172 lekë / m²). Subjekti ka sqaruar se për këtë shtesë ka shpenzuar shumën prej 500.000 lekësh.

1.10 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie (36 m²)

1.10.1 Në deklaratën për vitin 2003 subjekti e kishte deklaruar këtë pasuri në vlerën 1.5 milionë lekë.

1.10.2 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj vlere subjekti kishte deklaruar se për blerjen e kësaj pasurie kishte përdorur:

1.10.2.a Të ardhura nga shitja e ½ pjesë të pasurisë ap. 1+1, nga bashkëshortja e tij në shumën 400.000 lekë me kontratë nr. (***) , datë 9.8.1997 (e blerë në datën 21.12.1994, me kontratë nr. (***)), për të cilën Komisioni ka arsyetuar më sipër në pikën 1.5.5, si dhe;

1.10.2.b Të ardhura nga aktiviteti si stomatologe e bashkëshortes së tij, për periudhën janar 1996 – dhjetor 1998, si dhe pagën e tij si ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë.

1.11 Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i bashkëshortes, Drejtoria Rajonale e Tatimeve⁶, konfirmoi se shtetasja L. B. është e regjistruar në sistemin tatimor si person fizik me NIPT (***) , në datën 3.2.2003, krijuar në datën 17.3.1994 me aktivitet “Dentiste”. Kjo drejtori ka informuar se, që prej ushtrimit të aktivitetit, për periudhën prill 1994 – 2006 nuk dispononte të dhëna lidhur me fitimin *neto* të realizuar, por dispononte të dhëna vetëm mbi qarkullimin dhe taksën e paguar, ndërsa për periudhën 2008 – 2016, ka vënë në dispozicion të Komisionit të dhëna të sakta lidhur me qarkullimin dhe për fitimin *neto* nga aktiviteti i ushtruar nga bashkëshortja e subjektit.

1.12 Komisioni, nisur nga fakti i mungesës së fitimit *neto* (deri në vitin 2006, konfirmuar në nivel zyrtar nga DRT-ja), nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes së subjektit, si dhe nga domosdoshmëria për të mbledhur prova e fakte me qëllim kryerjen e një hetimi sa më objektiv dhe të gjithanshëm, për provueshmërinë e burimit të të ardhurave (pasqyruar deklarimi i subjektit në pikën 1.10.2.b), të pasurisë së blerë apo edhe të ndërtuar brenda vitit 1998, e ka pyetur⁷ subjektin mbi të ardhurat e fituara nga qarkullimi i aktivitetit të bashkëshortes së tij në vitet 1996, 1997 dhe 1998.

1.13 Subjekti ka pretenduar vlera më të larta të qarkullimit të biznesit të bashkëshortes së tij, nga ato të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. (***) prot.,

⁶ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 7.1.2019 të DRT-së Tiranë dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, në dosjen e Komisionit.

⁷ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 3, në pyetësin nr. 2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

datë 10.10.2019. Kjo e fundit ka konfirmuar se qarkullimi i aktivitetit të klinikës dentare që administrohej nga bashkëshortja, znj. L. B., ka qenë për vitin 1996 në vlerën 260.000 lekë, për vitin 1997 në vlerën 300.000 lekë dhe për vitin 1998 në vlerën 1.300.000 lekë. Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti ka depozituar disa fletënjoftime tatimore⁸, sipas të cilave rezultoi se ishin paguar detyrimet tatimore për këto vite.

1.14 Komisioni, gjithnjë për një hetim sa më objektiv për të konsideruar edhe pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat, megjithëse në nivel deklarativ, por duke pasur vlera qarkullimi në nivel zyrtar, për faktin se ushtrimi i aktivitetit daton në një kohë relativisht të largët, i kërkoi informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Urdhrit të Stomatologut, lidhur me *marzhën* e fitimit mbi qarkullimin e të ardhurave gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti për vitet e periudhës 1994 – 2007.

1.15 Urdhri i Stomatologut ka paraqitur opinion⁹ me disa argumente, nëpërmjet të cilëve me rezervë konfirmon: “*Marzha e fitimit në masën 85 % mund të justifikohet me faktin që mund të jetë cenuar cilësia dhe standardi duke punuar me materiale të cilësisë më të dobët të mundshme dhe me mungesë të plotë të personelit ndihmës dhe standardit të infrastrukturës në klinikën dentare*”.

1.16 Komisioni, për të përlllogaritur *marzhën* e fitimit nga aktiviteti i bashkëshortes së subjektit si stomatologe, me qëllim provueshmërinë e nivelit të të ardhurave si një ndër burimet e kësaj pasurie, ka analizuar disa faktorë të cilët pasqyrohen në metodologjinë më poshtë, prej nisjes së ushtrimit të aktivitetit privat dhe në vijim, faktorë të cilët bëjnë të pamundur mbajtjen e një *marzhe* fitimi *konsistente*.

Argumentet e përdorura në metodologji e kanë çuar Komisionin në llogaritjen e të ardhurave me *marzhë* fitimi për vitin 1996 – 75 %, për vitin 1997 – 75 % dhe për vitin 1998 – 70%, përlllogaritje të bëra për qarkullimin e deklaruar dhe të pasqyruar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për këto vite.

Më tej, për këtë pasuri Komisioni kreu analizën financiare pasqyruar në tabelën nr. 1 më poshtë, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit: *¹⁰dukej se nuk kishte pasur burime të ligjshme të mjaftueshme financiare në shumën 501.440 lekë për të blerë këtë pasuri në vitin 1997, për të ndërtuar shtesën me sip. 16 m² në vitin 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe, për pasojë, Komisioni i kaloi atij barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit.

Tabela nr.1

	Viti i blerjes	Gusht 1997 dhe korrik 1998
	Përshkrimi	Apartament me sip. (20+16) 36 m ² , në Rr. “(***)”, Tiranë (përshtatur për klinikë).
	Vlera e investimit	1.500.000 lekë
Burimi i krijimit	Shitja 1/2 pasurisë ap.1+1 bashkëshortja	400.000 lekë
	Të ardhura nga klinika 1996 – 1998	420.000 lekë
	Paga ndihmësgjyqtar Kuçovë 1996 – 1998	538.560 lekë
	Shpenzime jetese	360.000 lekë
	Diferenca (të ardhura - shpenzime)	-501.440 lekë

⁸ Fletënjoftim tatimor me nr. regjistri 180 6002 për tatimpaguesen L. M. B.; fletënjoftim tatimor për vitin 1998 me nr. regjistri (***) , për tatimpaguesen L. M. B. etj.

⁹ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 15.4.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁰ Shenja (*) i referohet në çdo rast konstatimeve të Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, të cilat i janë dërguar subjektit si barrë prove ose për të dhënë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, në prapësimet e tij, subjekti ka cituar shprehimisht: “...duke marrë në konsideratë ata faktorë që thekson edhe Komisioni në këtë metodologji, por edhe opinionin e Urdhrit të Stomatologut, për periudhën e viteve 1995 – 1997 pranoj si të përshtatshme vlerën e marzhës së caktuar nga Komisioni, por pretendoj si më reale marzhën e fitimit neto, në vlerën e 80 % të xhiros qarkulluese të klinikës dentare (vlerësim mesatar mes përcaktimit të Urdhrit të Mjekut, në shkresën nr. (***) , datë 15.4.2019 dhe përcaktimit të Komisionit)”, ndërsa për vitin 1998, subjekti ka cituar: “...për periudhën pasuese, në vitet 1998 – 1999 – 2000 – 2001, pretendoj se norma më e përshtatshme e fitimit neto, në raport me xhiron qarkulluese duhet të llogaritet në vlerën 75 %.”

Në prapësimet e tij subjekti ka pasqyruar përlllogaritjet e kryera për secilën pasuri nga eksperti kontabël, z. Q. L., sipas të cilit janë llogaritur *marzhe* më të larta fitimi nga ato të Komisionit, lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i bashkëshortes së tij. Subjekti ka pretenduar një mesatare mes *marzhave* të fitimit të Urdhrit të Stomatologut dhe atij të përlllogaritur nga Komisioni.

Subjekti ka sqaruar edhe në lidhje me deklarimin e tij mbi shpenzimin e kryer për pasurinë 16 m² në shumën 500.000 lekë. Ai ka qartësuar se vlera e shpenzuar për ndërtimin e shtesës ka kapur shifrën 298.770 lekë dhe jo 500.000 lekë, pasi kjo e fundit përfshin edhe shpenzimet e bëra për vendosjen e dritareve dhe kryerjen e disa punimeve të tjera të shtesës në vitin 2002. Për të provuar pretendimin e tij subjekti depozitoi situacionin e punimeve, si dhe aktin e kolaudimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Bazuar në referimet dhe argumentet e metodologjisë së përdorur, të marrë në konsideratë edhe nga subjekti i rivlerësimit duke pretenduar që të llogaritej një *marzhë* fitimi më real se ai i Komisionit, në kushtet që nga institucionet përkatëse nuk rezultoi të konfirmohej fitimi *neto*, por vetëm qarkullimi, trupi gjykues për një vlerësim objektiv rillogariti të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes për këto tri vjet, përkatësisht sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit dhe, më specifikisht:

- për vitin 1996 në shumën 208.000 lekë, me *marzhë* fitimi të aplikuar sipas pretendimit të tij në masën 80 %;
- për vitin 1997 në shumën 240.000 lekë, me *marzhë* fitimi të aplikuar po sipas pretendimit të tij në masën 80 %; dhe
- për vitin 1998 në shumën 975.000 lekë, me *marzhë* fitimi të aplikuar sipas pretendimit të tij në masën 75 %, përlllogaritje të kryera gjithnjë mbi qarkullimin e deklaruar për këto vite në nivel zyrtar.

Lidhur me pretendimin e subjektit se vlera e shpenzuar për ndërtimin e shtesës prej 16 m² ka qenë në vlerën 298.770 lekë dhe jo vlerën 500.000 lekë (pasi kjo e fundit ka qenë vlera e deklaruar, ku përveç vlerës së shpenzuar për ndërtimin e pasurisë, pjesa tjetër e shumës është përdorur për vendosjen e dritareve dhe për kryerjen e disa punimeve të tjera të shtesës në vitin 2002), Komisioni, në analizim të dokumentacionit, situacion punimesh, si dhe aktkolaudimin, se vlera e shpenzuar e ndërtimit të shtesës 16 m² ishte në vlerën 298.770 lekë dhe, për pasojë, kreu rillogaritjet financiare për vitin 1998, duke përfshirë këtë shumë. Ndërsa shuma e mbetur si diferencë nga shuma 500.000 lekë u përlllogarit në analizën financiare të vitit 2002.

- ✓ Trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën e shpenzuar për ndërtimin e pasurisë shtesë me sip. 16 m², si dhe ka mungesë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në shumën 251.440 lekë, referuar në tabelën përmbledhëse nr. 4, për pasuritë përpara vitit 2003.

2. Në lidhje apartament 2+1, me sip. 116 m², ndodhur në Rr. “(*)”, me nr. pasurie (***)**, vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) , regjistruar në datën 6.5.2005, blerë në vlerën 3.000.000 lekë nga firma ndërtuese “S.” sh.p.k. e përfaqësuar nga shtetasi A. S., me kontratën noteriale nr. (***) , datë 30.11.2000, si dhe shpenzuar pas blerjes edhe vlera prej 1.000.000 lekësh për arredimin e tij. Pasuri e rivlerësuar në datën 17.10.2011, në vlerën e tregut 10.440.000 lekë. Pjesa takuese: 50 % + 50 %.

2.1 Burimi i deklaruar i krijimit: në datën 8.8.2000, është likuiduar depozita prej 4.000.000 lekësh, në Bankën e Kursimeve, Agjencia nr. 1, Kuçovë, nr. (***) , depozitë e krijuar:

- a) prej të ardhurave nga aktiviteti si stomatologe i bashkëshortes në periudhën janar 1999 – gusht 2000;
- b) prej të ardhurave nga shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi 1+1, L. “(***)”, Kuçovë, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 9.11.1998, në vlerën 850.000 lekë.

2.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹¹.

2.3 ILDKPKI-ja në konstatimet e saj është shprehur: “*Deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti përputhet me përgjigjen e marrë nga ZVRPP-ja Tiranë*”.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

2.4 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2003 me të njëjtin burim krijimi si në deklaratën “Vetting”.

2.5 ZVRPP-ja¹² Tiranë e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit në bashkëpronësi me bashkëshorten e tij, si apartament me sip. 116 m², regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, me nr. (*) , vol. (***) , f. (***) , z.k. (***) .**

2.6 Nga aktet rezultoi se subjekti e kishte blerë këtë apartament me kontratën nr. (*) , datë 30.11.2000, nga shoqëria “S.” sh.p.k. në shumën 3.000.000 lekë, shumë e cila citohet në kontratë se është likuiduar nga subjekti i rivlerësimit jashtë zyrës noteriale.**

2.7 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

- Për këtë pasuri subjekti kishte deklaruar se kishte përdorur depozitën prej 4.000.000 lekësh të tërhequr në datën 8.8.2000.

- Subjekti deklaronte se kjo depozitë ishte krijuar nga:

- i. Aktiviteti si stomatologe e bashkëshortes së tij në periudhën janar 1999 – gusht 2000.
- ii. Të ardhurat nga shitja e apartamentit të përfituar nga privatizimi 1+1, Lagja “(***)”, Kuçovë, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 9.11.1998, në vlerën 850.000 lekë.

- Komisioni hetoi në lidhje me të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i bashkëshortes si stomatologe në qytetin e Kuçovës, në periudhën janar 1999 – gusht 2000.

- Komisioni e pyeti¹³ subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite (vlera 4.000.000 lekë), si dhe i kërkoi të depozitonte dokumentacionin bankar për këtë depozitë, qysh nga dita e parë e hapjes dhe deri në likuidimin e saj.

¹¹ Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 6.5.2005, për pasurinë me nr. (***) , e llojit apartament me sip. 116 m², në pronësi të shtetasve Gurali dhe L. B. .

- Kartela e pasurisë së apartamentit me sip. 116 m². Rivlerësuar në datën 17.10.2011 në vlerën 10.440.000 lekë. Kontratë shitblerjeje datë 30.11.2000, për apartament me sip. 116 m², me palë blerëse shtetasit Gurali dhe L. B., me palë shitëse shoqërinë “S.” sh.p.k. Vlera: 3.000.000 lekë, e likuiduar etj. (aneks. nr. 4/3), (aneks. nr. 4/6), në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 7.1.2019, në dosjen e Komisionit.

¹³ Referojuni pyetjes 23 të pyetësorit nr. 2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

- Subjekti, së bashku me përgjigjen e tij, ka depozituar disa dokumente¹⁴, sipas të cilave rezultoi se “Raiffeisen Bank”, me shkresën e datës 27.2.2019, konfirmon: “Klienti Gurali M. Brahimllari në datën 3.5.2000 ka çelur në Bankën e Kursimeve – Agjencia Bankare Kuçovë një depozitë me afat 3-mujor, me numër (***) , në monedhën “Lekë” në shumën fillestare 3.900.000 lekë, me normë interesi në këtë datë 8 %”. Bazuar në shkresën nr. (***) , të datës 23.5.2000, të Bankës së Kursimeve – Agjencia Kuçovë, rezulton se kjo depozitë është transferuar në Bankën e Kursimeve Tirana 3 – Agjencia Bankare Nr. 1.

- Komisionit i rezultoi se kjo depozitë (me nr. (***)) në emrin e subjektit, datë 3.5.2000, ishte krijuar si rezultat i bashkimit të dy depozitave të mëparshme, përkatësisht të asaj me nr. (***) , në vlerën 1.931.024 lekë dhe të depozitës nr. (***) – kjo e fundit, sipas regjistrimeve manuale, pasurohej vazhdimisht me shuma prej 100.000 lekësh, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. L. Br. .

- Nga analizimi dhe krahasimi i dokumentacionit të depozituara në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 24.1.2019, rezultoi se depozitat janë krijuar prej vitit 1998 deri në datën 3.5.2000.

- Komisioni, pasi nuk konstatoi paqartësi në provat e depozituara, kreu analizën financiare. Në analizë u përllogaritën të ardhurat e krijuara për këtë depozitë deri në datën e hapjes së saj, më 3.5.2000, pavarësisht se subjekti pretendonte se të ardhurat përfshinin periudhën deri në muajin gusht 2000 (kur ishte tërhequr depozita). Për më shumë qartësi Komisioni kreu këtë përllogaritje, për arsye se depozita në shumën prej 3.900.000 lekësh ishte hapur nga subjekti në datën 3.5.2000, çka nënkuptonte që të ardhurat nga klinika dentare i përkisnin periudhës deri në muajin prill të vitit 2000¹⁵.

- Sikurse u arsyetua edhe në pasurinë nr. 1, Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me vlerësimin e *marzhës* së fitimit (sipas argumenteve të pasqyruara në metodologji) edhe për këtë periudhë (viti 1999 – 3.5.2000), për të cilën nuk është administruar në nivel zyrtar asnjë e dhënë mbi fitimin *neto*, por vetëm mbi qarkullimin. *Marzha* e fitimit, e vlerësuar për të kryer përllogaritjet lidhur me mundësinë e krijimit të të ardhurave nga ky aktivitet më tej, si një ndër burimet e krijimit të depozitës prej 3.900.000 lekësh, shumë e cila është përdorur si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie, është përllogaritur në masën 70 % mbi qarkullimin.

2.7.2 Gjithashtu, Komisioni hetoi edhe lidhur me burimin tjetër të deklaruar për krijimin e kësaj pasurie, në lidhje në vlerën 850.000 lekë, e ardhur e deklaruar nga subjekti, nga shitja e apartamentit të përfutur nga privatizimi 1+1, lagja “(***)”, Kuçovë, sipas kontratës nr. (***) , datë 9.11.1998.

- Nga aktet e administruara nga praktika e ZVRPP-së Kuçovë, me shkresën nr. (***) prot., datë 14.9.2017, konfirmohet se apartamenti me sip. 48 m², me nr. pasurie (***) , z.k. (***) , vol. (***) , f. (***) , ka qenë në bashkëpronësi të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, përfutur sipas ligjit të privatizimit të banesave shtetërore, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 12.12.1994, me Ndërmarrjen Komunale Banesa Kuçovë, kundrejt vlerës 13.498 lekë.

- Po ashtu, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 9.11.1998, subjekti dhe bashkëshortja e tij e kishin shitur këtë pasuri në vlerën 850.000 lekë.

2.7.3 Komisioni, pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, kreu analizën financiare të pasqyruar në tabelën nr. 2, nga ku: *dukej se subjekti nuk kishte pasur burime të mjaftueshme financiare në shumën prej 766.390 lekësh për të krijuar depozitën në shumën 4.000.000 lekë

¹⁴ Referohuni përgjigjes së pyetjes nr. 23, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur në pyetësorin nr. 2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Referojuni për më shumë metodologjisë së përdorur, e cila është pjesë integrale e këtij vendimi.

dhe, për pasojë, nuk kishte pasur mundësi për blerjen e pasurisë apartament 2+1, me sip. 116 m², ndodhur në Tiranë, si dhe për të bërë arredimin e tij. Për këtë konstatim i kaloi subjektit barrën e provës.

Tabela nr. 2

	Viti i blerjes	22.12.2000
	Përshkrimi	Apartament 2+1, Rr: “(***), sip. 116 m ² , Tiranë (3.000.000 + 1.000.000 lekë)
	Vlera e investimit	4.000.000
	Depozita	3.900.000
Burimi i krijimit të depozitës së përdorur për këtë investim	Të ardhura nga klinika 1998 – prill 2000	2.283.610
	Shitje ap.1+1 përfituar nga privatizimi, datë 9.11.1998	850.000
	Diferenca (të ardhura - shpenzime)	-766.390

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, ka cituar shprehimisht: “... për periudhën pasuese, në vitet 1998 – 1999 – 2000 – 2001, pretendoj se norma më e përshtatshme e fitimit neto, në raport me xhiron qarkulluese, duhet të llogaritet në vlerën 75 %.”

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nuk janë përfshirë interesat bankare të kësaj depozite. Për këtë subjekti ka depozituar kartelat përkatëse të depozitës, si edhe analizën e ish-punonjësës së Bankës së Kursimeve mbi përllogaritjet e interesave.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues sikurse ka arsyetuar edhe në pasurinë nr. 1, edhe për këtë pasuri analizoi me objektivitet pretendimet e subjektit duke konsideruar *marzhën* e fitimit në masën 75 % dhe për pasojë kreu rillogaritjet në analizën financiare.

Gjithashtu, trupi gjykues pas analizimit provave të depozituara konstatoi se qëndronte pretendimi i subjektit lidhur me mospërfshirjen në analizën financiare të interesave bankare të depozitës në vlerën prej 3.900.000 lekësh e cila ka shërbyer si burim për investimin e kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë kreu rillogaritjet përkatëse.

- ✓ Trupi gjykues, pas kryerjes së analizës financiare, duke i qëndruar dhe duke pranuar pretendimin e subjektit, konstatoi se edhe në këtë variant subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, në shumën 186.778 lekë, referuar në tabelën përmbledhëse nr. 4, “Për pasuritë përpara vitit 2003”.

Në vijim, gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se përpara vitit 2003 ishte ndërtuar edhe pasuria *klinikë dentare* në qytetin e Kuçovës, pasuri të cilën bashkëshortja e subjektit e kishte përdorur për ushtrimin e aktivitetit të saj deri në vitin 2002 dhe që të ardhurat nga shitja e saj kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë nr. 4 të deklaruar në deklaratën “Vetting”, si më poshtë arsyetuar.

Komisioni hetoi lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie me sip. 38.25 m² me nr. pasurie (***), ndërtuar sipas lejes sheshndërtimi nr. (***), datë 14.2.1995, shitur në vitin 2012.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

- Në deklaratën për vitin 2003 subjekti e kishte deklaruar këtë pasuri të ndërtuar me leje ndërtimi në vitin 1995, në qytetin e Kuçovës, mjedis për të cilin ka deklaruar se në të kishte ushtruar aktivitetin bashkëshortja e tij deri në vitin 2002.

- Në vitin 2012 subjekti ka deklaruar se ka formalizuar kontratën e shitjes¹⁶ së kësaj pasurie në shumën 4.000.000 lekë, me vëllanë e bashkëshortes, shtetasin A. S. .

- Kjo shumë është deklaruar nga subjekti se ishte dhënë përpara kontratës së shitjes si hua, përkatësisht e ndarë: në vitin 2002 në vlerën 1.500.000 lekë dhe në vitin 2008 në vlerën 19.000 euro (e deklaruar se është përdorur për pagesën e këstit të parë të pasurisë nr. 4).

- Për shkak se nga shitja e kësaj pasurie janë gjeneruar të ardhura në shumën 4.0000.000 lekë, të përdorura si burim krijimi në pasurinë “Vetting”, subjekti është pyetur në lidhje me shumën e shpenzuar për ndërtimin e saj, si dhe në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

- Në pyetësoin e datës 24.1.2019 subjekti ka deklaruar¹⁷ se për këtë pasuri kishte shpenzuar vlerën më pak se 800.000 lekë.

- Komisioni, pasi kreu analizën financiare, konstatoi se: *dukej se subjekti nuk kishte pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në shumën prej 630.973 lekësh për të realizuar ndërtimin e kësaj pasurie, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera të jetesës (referojuni tabelës nr. 8) dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës.

Tabela¹⁸ nr. 3

	Viti i blerjes	1995
	Përshkrimi	Klinikë dentare, me sip. 50 m ² , Kuçovë + trualli 38.25 m ² (14.8.2012)
Burimi i krijimit	Vlera e investimit	800.000
	Të ardhura nga klinika 95	71.265
	Paga, subjekti, 1994 –1995	210.446
	Shpenzime jetese	112.684
	Diferenca (të ardhura – shpenzime)	-630,973

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, subjekti ka kërkuar që të vlerësohet dhe të merret në konsideratë tabela e re e rindërtuar me asistencën e ekspertit kontabël.

Subjekti ka pretenduar se në përlllogaritjet financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e ligjshme të vitit 1994. Subjekti ka cituar: “... nuk ka asnjë arsye që në të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë klinikë dentare me sip. 38.25 m², të mos merren në konsideratë të ardhurat nga puna e bashkëshortes në vitin 1994 si stomatologe (edhe në profesion privat), të paktën për aq sa është paguar tatim të këtij viti...ose minimalisht Komisioni duhet të merrte në konsideratë vlerën e të ardhurave të ligjshme, për të cilat është paguar tatim në vitin 1995, si referencë për të përcaktuar dhe për të llogaritur atë të vitit 1994. Pra, për secilin nga këto vite edhe me marzhën e fitimit të llogaritur nga Komisioni në vlerën 75 % të xhiros qarkulluese, të ardhurat nga klinika duhet të llogariten në vlerën 71.265 lekë, jo vetëm për vitin 1995, por edhe për vitin 1994. Sikurse del nga dokumentacioni i klinikës dentare, kursimet përpara se të merrej leja e ndërtimit për këtë pasuri e në funksion të saj është demonstruar vlera rreth 75.000 lekë si depozitë në bankë (e barabartë me 15 % të vlerës parashikuese për ndërtimin e klinikës kur u mor leja për shesh ndërtimi që ishte rreth 500.000 lekë). Në mungesë të dokumentacionit dhe faturave për ndërtimin e kësaj pasurie, në këto prapësime për rezultatet e hetimit administrativ të datës 15.5.2019 subjekti pretendoi se vlera ndërtimore e pasurisë me sip. 38.25 m² ka qenë 489.026 lekë. Kjo vlerë pasqyrohet nga VKM-ja nr. 815, datë 9.12.1996, e cila

¹⁶ Referojuni kontratës nr. (***) , datë 14.8.2012, në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Referojuni përgjigjes së pyetjes 14, në pyetësoin.

¹⁸ Në rezultatet e hetimit, ishte tabela nr. 8.

përcakton se kostoja e ndërtimit në qytetin e Kuçovës për vitin 1995 duhet të llogaritet në vlerën 12.785 lekë/m².

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit “*Fletënjoftim tatimi për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 1994 dhe mandatarkëtimet për këto pagesa*” për biznesin e bashkëshortes së subjektit, arriti në konkluzion se ajo ka ushtruar aktivitetet privat dhe, për pasojë, ka krijuar të ardhura prej tij.

Trupi gjykues, i ndodhur përpara faktit të mungesës së informacionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për qarkullimin e vitit 1994, pretendimit të subjektit se bashkëshortja e tij nga muaji prill 1994 ka ushtruar aktivitetet privat, të cilin e provojnë edhe mandatpagesat që ka paguar tatim dhe, për pasojë, ka krijuar të ardhura, të cilat sipas tij duhet të merren në konsideratë, ka vlerësuar që këto të ardhura të pretenduara për këtë vit, si dhe për vitin e investimit në ndërtimin (1995) e kësaj pasurie, në çdo lloj mase të mundshme të krijuar, të përlllogariten si shpenzime jetese për familjen e subjektit. Nën këtë argumentim trupi gjykues ka vlerësuar neutralizimin mes këtyre të ardhurave dhe shpenzimeve familjare.

Për sa i përket pretendimit të vlerës së investimit për këtë pasuri, trupi gjykues vëren se subjekti është kontradiktor në deklaratimet e tij kur kërkon që të konsiderohet vlera 489.026 lekë e ndërtimit, sipas kostos së parashikuar në VKM-në nr. 815, datë 9.12.1996 (akt të cilin e depozitoi vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit), ndërsa gjatë hetimit administrativ edhe në përgjigje të pyetësorëve ka deklaruar se kostoja e përlllogaritur në rivlerësimin nga ZVRPP-ja Kuçovë është bazuar në vlerën 747.596 lekë. Nën këtë arsyetim trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe as të bazuara në prova.

- ✓ Në konkluzion, trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe provave, sipas arsyesimit të mësipërm, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në shumën 513,538 lekë, referuar në tabelën përmbledhëse nr. 4, “*Për pasuritë përpara vitit 2003*”.

Tabela nr. 4 përmbledhëse për pasuritë e krijuara përpara vitit 2003

Viti i krijimit	Përshkrimi	Vlera e investimit	Të ardhura	Shpenzime	Balanca
Gusht 1997 dhe korrik 1998	Apartament me sip. (20 + 16) 36 m ² , Rr. “(***)” në Tiranë (përshtatur për klinikë)	1,278,000	1,386,560	360,000	(251,440)
22.12.2000	Apartament 2+1, me sip. 116 m ² , Rr. “(***)”, Tiranë (3.000.000 lekë ap. + 1.000.000 lekë arredimi)	4,000,000	3,813,222		(186,778)
1995	Klinikë dentare me sip. 50 m ² , Kuçovë	800,000	286,462		(513,538)
Totali për pasuritë e krijuara para vitit 2003					(951,756)

➤ **Në përfundim, për pasuritë nr. 1 dhe 2, si dhe për ndërtimin e klinikës në qytetin e Kuçovë, të krijuara përpara vitit 2003, trajtuar sa më sipër:**

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe në shqyrtimin e rrethanave në tërësi të këtyre pasurive, trupi gjykues arrin në konkluzion se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi, bazuar në analizën financiare, rezulton se ka mungesë të të ardhurave në shumën **951,756 lekë** për të justifikuar: (i) blerjen dhe ndërtimin e pasurisë nr. 1, në vitin

1997 – 1998, ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën e shpenzuar për ndërtimin e pasurisë shtesë me sip.16 m²; (ii) investimin në pasurinë nr. 2 në vitin 2000; (iii) ndërtimin e klinikës dentare në qytetin e Kuçovës në vitin 1995; si dhe (iv) ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj klinike.

→ Në lidhje me pasurinë e krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në vitin 2004 – 2005.

3. Në lidhje me pasurinë njësi (klinikë dentare) me sip. 74.3 m², nr. pasurie (***), z.k. (***), vol. (***), f. (***), ndodhur në Rrugën (***), fituar sipas kontratës së porosisë datë 9.6.2004, te “D.” sh.p.k. me administrator z. Z. K., me vlerën 93.000 euro, dorëzuar në datën 25.3.2006, me procesverbal, financiar me këste, gjatë viteve 2004 – 2005, regjistruar në datën 18.6.2012, me kontratë shitjeje noteriale nr. (***), datë 1.6.2012, në vlerën 11.600.000 lekë.

3.1 Burim i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie

a) Likuidimi:

- e depozitës nr. (***), datë 19.6.2000, tek “Alpha Bank”, dega Tiranë, në emër të subjektit; në datën 31.12.2003 gjendje në vlerën 1.400.073 lekë;
- e depozitës nr. (***), datë 25.11.2002, në “Bankën e Kursimeve”, Agjencia nr. 1, Tiranë, në emër të subjektit, e rinovuar në datën 2.9.2004, nr. (***), vlera 2.011.039,36 lekë; *si dhe*
- e depozitës nr. (***), datë 23.10.2003, në “Alpha Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit, depozitë e cila përfshinte vlerën prej 1.500.000 lekësh nga kësti i parë i shitjes së ish-klinikës dentare në Kuçovë (të ardhurat që kanë qenë të depozituara në banka janë deklaruar në ILDKPKI në muajin mars 2004).

b) Kredi në “Alpha Bank”, sipas kontratës nr. (***), datë 12.5.2005, lëvruar në datën 26.5.2005, në vlerën 50.000 euro, lënë hipotekë apartamenti me nr. 116 m², me interes 6.12 %, kësti 3-mujor: 1.250 euro. Likuiduar në total në datën 13.8.2008, pa penalitet. Paguar interesa në vlerën rreth 5.000 euro.

c) Të ardhura nga paga e subjektit, si dhe nga veprimtaria si stomatologe e bashkëshortes, në periudhën janar 2001 – maj 2005 (*deri në likuidimin e shumës së kontratës*), si dhe në periudhën qershor 2005 – maj 2008, për shlyerjen e kredisë së marrë për klinikën.

3.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën disa dokumente.¹⁹

3.3 ILDKPKI-ja, në konkluzionin e saj, është shprehur: “Si burim për krijimin e këtij aseti, përveç kredisë 50.000 euro në “Alpha Bank”, është përdorur edhe mbyllja e depozitave në “Bankën e Kursimeve” dhe në “Alpha Bank”, të cilat janë deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës 2003 me një vlerë totale prej 5.050.000 lekësh”.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

3.4 Komisioni ka kryer hetimin administrativ²⁰ përkatës për këtë pasuri nga ku rezultoi se subjekti kishte regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë e llojit “Njësi”, me sip. 74.3 m², me nr. (*), vol. (***), f. (***), z.k. (***), në bashkëpronësi me bashkëshorten, znj. L. B. .**

3.5 Sipas kartelës së kësaj pasurie, kjo pasuri është rivlerësuar në datën 8.8.2012, në vlerën 22.396.000 lekë.

¹⁹ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. (***), datë 18.6.2012, për pasurinë e llojit “njësi” me sip. 74.3 m², me nr. (***), në pronësi të shtetasve Gurali dhe L. B. . Kartela e pasurisë së njësisë me sip. 74.3 m². Kontratë sipërmarrje paraprake për ndërtimin e godinës. Pronar trualli: Xh. T. . Sipërmarrës: shoqëria “D.” sh.p.k. Kontratë sipërmarrje datë 9.6.2004, për ambient me sipërfaqe të përgjithshme 90 m², në vlerën 93.000 euro ose 11.600.000 lekë. Porositës: Gurali Brahimllari. Ndërtues: shoqëria “D.” sh.p.k. (aneks nr.4/4), (aneks nr. 4/6), në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Referojuni shkresës nr. (***), datë 7.1.2019, së ZVRPP-së Tiranë dhe dokumentacionit bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

3.6 Pasuria rezulton të jetë blerë nga subjekti i rivlerësimit në çmimin 93.000 euro nga shoqëria “D.” sh.p.k. Në kontratë është pasqyruar se shuma e blerjes së kësaj pasurie është likuiduar tërësisht nga blerësi që në vitin 2005, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 9.6.2004, përpara regjistrimit të pasurisë në hipotekë.

3.7 Në deklaratën për vitin 2004 subjekti ka deklaruar se ka porositur një ambient rreth 79 m², për klinikë dentare në katin II, në “Rrugën (***)” te firma e ndërtimit “D.” sh.p.k., me pronar shtetasin Z. K., e cila do të përfundohej brenda muajit qershor 2005 dhe se nga data 9.6.2004, deri në datën 31.12. 2004 kishte paguar vlerën rreth 43.000 euro, me burim krijimi: *nga tërheqja dhe mbyllja e depozitës nr. (***)*, datë 25.11.2002, në “Bankën e Kursimeve”, e depozitës nr. (***), datë 10.12.2003 në “Alpha Bank”, dega Tiranë, si dhe e depozitës nr. (***), datë 19.6.2000, në “Tirana Bank”.

3.8 Në deklaratën për vitin 2005 subjekti ka deklaruar se ka vazhduar ndërtimin e këtij ambienti të pronuar në vitin 2004 dhe se për këtë pasuri kishte shpenzuar vlerën prej 55.000 eurosh me burim: 50.000 euro përfituar kredi bankare në “Alpha Bank” sipas kontratës nr. (***), datë 12.5.2005, me datë lëvrimi 26.5.2005, me afat shlyerje 10 vjet me këste tre mujore, kredi të cilën rezulton se e ka shlyer në vitin 2008.

3.9 Në deklaratën për vitin 2012 subjekti ka deklaruar regjistrimin e kësaj pasurie me sip. 74.3 m² (sipas kontratës nr. (***), datë 18.6.2012, z. k. (***), vol. (***), f. (***), e prejardhur fillimisht sipas kontratës së porosisë, datë 9.6.2004, me firmën “D.” sh.p.k., këstet shlyer në vitet 2004 – 2005), në vlerën 93.000 euro, në pjesë takuese: 50 %. Po në këtë vit subjekti ka deklaruar se e ka rivlerësuar këtë pasuri, se kishte paguar tarifën 1 %, si dhe shumën 95.796 lekë për rivlerësimin e saj.

3.10 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

3.10.1 Komisioni hetoi mbi krijimin dhe likuidimin e depozitave:

a) Në deklaratën për vitin 2003 subjekti ka deklaruar: librezë kursimi nr. (***), datë 19.6.2000, me shumën 1.4 milionë lekë, në “Tirana Bank”, me burim krijimi: *nga të ardhurat e tij familjare*.

b) Në deklaratën për vitin 2003 subjekti ka deklaruar: depozitë kursimi nr. (***), datë 25.11.2002, në vlerën 1.950.000 lekë, në “Bankën e Kursimeve” – Agjencia Bankare nr.1, Tiranë, me burim krijimi: *nga të ardhurat e tij familjare*.

c) Në deklaratën për vitin 2003 subjekti ka deklaruar: depozitë kursimi nr. (***), datë 10.12.2003, në vlerën 200.000 lekë, në Bankën e Kursimeve – Agjencia Bankare nr.1, Tiranë, me burim krijimi: *nga të ardhurat e tij familjare*.

3.11 Komisioni, nisur nga fakti se nuk kishte të administruar asnjë dokumentacion provues lidhur me ekzistencën e depozitës nr. (***), datë 10.12.2003, e ka pyetur subjektin e rivlerësimit.

3.12 Në përgjigje të pyetësorit²¹ subjekti ka sqaruar: “...për depozitën nr. (***), në “Bankën e Kursimeve” – Agjencia Bankare nr. 1, Tiranë, e cila është krijuar në datën **10.12.2003**, nuk ka mundur të gjejë as kartelën dhe as gjurmë në sistemin elektronik dhe as datën e saktë të tërheqjes së saj, gjë që sipas shkresës së dërguar nga “Raiffeisen Bank” në datën 27.2.2019, mund të jetë për shkak të afatit të shkurtër të ekzistencës së kësaj depozite”.

- Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni, me gjithë dërgimin e rezultateve të hetimit, mbajti korrespondencë me “Raiffeisen Bank”²², nga ku u konfirmua ekzistenca e kësaj depozite në shumën 200.000 lekë.

²¹ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit datë 24.1.2019 dhe datë 11.4.2019, në dosjen e Komisionit.

²² Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 20.5.2019, në dosjen e Komisionit.

3.13 Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se për këtë pasuri kishte përdorur si burim për likuidimin e depozitës nr. (***) , datë 23.10.2003 në “Alpha Bank”, e cila përfshinte vlerën prej 1.500.000 lekësh, shumë kjo e deklaruar si pagesë e këstit të parë të shitjes së ish-klinikës dentare në Kuçovë (për ndërtimin e të cilës Komisioni arsyetoi më sipër).

3.14 Komisionit i ka rezultuar se kjo depozitë nuk ishte përdorur si burim krijimi për këtë pasuri, sepse, bazuar në *statement*-in bankar, në fund të vitit 2004 kjo depozitë rezultonte të ishte ende e patërhequr. Kjo depozitë rezultonte se ishte tërhequr në datën 30.3.2005, në vlerën 1.613.000 lekë.

3.15 Komisioni e ka pyetur²³ subjektin në lidhje me këtë mospërputhje, për të qartësuar burimin e saktë të krijimit të kësaj pasurie.

3.16 Në përgjigjen e dhënë subjekti ka cituar: “...kjo depozitë është përdorur nga bashkëshortja për blerjen e aparaturës “Kavo”, në shumën 15.100 euro... Shuma e marrë hua nga kunati, A. S. (vëllai i bashkëshortes), është depozituar në datën 23.10.2003, në “Alpha Bank” në emër të bashkëshortes. Kjo depozitë është mbyllur dhe vlera e arrirë e saj 1.613.000 (një milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë) lekë është tërhequr nga banka në datën 30.3.2005. Kjo shumë është përdorur prej bashkëshortes për të përballuar shpenzimet për blerjen e aparaturës së parë “Kavo” te firma “M.” sh.p.k.,” dhe për këtë subjekti ka depozituar faturën për porosinë/blerjen e aparaturës “Kavo”, të nënshkruar me firmën “M.”, në datën 31.3.2005”.

3.17 Komisionit i rezultoi se në deklaratën për vitin 2005 subjekti kishte deklaruar se kishte blerë në datën 31.3.2005 një aparaturë dentare Unit Dentar “Kavo” në shumën 15.100 euro, në pjesë takuese 50 %, por, pa deklaruar burimin e krijimit të shumës.

3.18 Komisioni ka kryer analizën financiare, duke analizuar dhe duke përllogaritur mundësinë e krijimit të dy depozitave financiare (*depozitës nr. (***) , datë 19.6.2000 dhe depozitës nr. (***) , datë 25.11.2002*). Në këtë analizë është përjashtuar depozita në shumën 1.500.000 lekë e bashkëshortes së subjektit, e krijuar si rezultat i shitjes së ish-klinikës së Kuçovës, pasi ishte tërhequr pas shlyerjes së kësteve të kësaj pasurie dhe ishte përdorur për blerjen e aparaturës dentare.

Gjithashtu, Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e shlyerjes së kredisë për vitet 2005 – 2008, për shkak se për këtë pasuri është përdorur kredia e marrë nga subjekti në vitin 2005 në shumën 50.000 euro, e cila rezultoi e shlyer tërësisht në vitin 2008.

Komisioni në kryerjen e analizës financiare për krijimin e të ardhurave nga aktiviteti privat i bashkëshortes së subjektit, sikurse ka arsyetuar në pasuritë e krijuara përpara vitit 2003, ka mbajtur në konsideratë qarkullimin e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe ka përllogaritur *marzhën* e mundshme të fitimit me argumentet e pasqyruar në metodologji.

Komisionit, në përfundim të hetimit administrativ, të analizimit të provave të administruara, të përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, si dhe të dokumenteve të depozituara prej tij, i rezultoi se: *dukej se për vitin 2004 subjekti nuk kishte pasur burime të mjaftueshme financiare në shumën 263.706 lekë për të paguar këstet e kësaj pasurie, si dhe shpenzimet e tjera familjare; dukej se kishte mospërputhje të deklaratimit të subjektit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme/klinikë, pasi në deklaratën “Vetting” subjekti kishte deklaruar depozitën nr(***) në “Alpha Bank”, si dhe gjatë hetimit administrativ, ku kishte deklaruar se kjo depozitë ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e pajisjes dentare; dukej se kishte mospërputhje për burimin e deklaruar të kësaj pasurie, pasi në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk deklaronte depozitën nr. (***) , në “Bankën e Kursimeve”, ndërkohë që në deklaratën periodike për vitin

²³ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr.19, në pyetësorin nr.2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit, si dhe përgjigjeve të pyetësorit datë 11.4.2019, në dosjen e Komisionit.

2004 dhe gjatë hetimit administrativ deklaroi si burim krijimi edhe mbylljen e kësaj depozite, në shumën 200.000 lekë; dukej se kishte mungesë dokumentacioni për të provuar ekzistencën e depozitës në “Bankën e Kursimeve”, nr. (***), në shumën 200.000 lekë të deklaruar prej tij dhe, për pasojë, i kaloi atij barrën e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar deklarimit të tij se depozitën prej 1.500.000 lekësh nuk e ka përdorur si burim krijimi për këtë pasuri.

Subjekti i qëndroi faktit të ekzistencës së depozitës bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 200.000 lekë dhe se ajo është përdorur në vitin 2004 për përballimin e shpenzimeve, përfshirë edhe ato të kryera atë vit për krijimin e pasurisë me sip. 74.3 m².

Subjekti ka pretenduar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve për vitin 2004 për këtë pasuri.

Subjekti ka pretenduar, sikurse edhe në pasuritë e lartpërmendura, për përlllogaritje të një *marzha* më të lartë fitimi mbi qarkullimin e xhiros së aktivitetit të bashkëshortes së tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank” – sipas të cilit u konfirmua ekzistenca e shumës 200.000 lekë – në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni kreu rillogaritjet financiare, duke përfshirë në analizë edhe këtë shumë si burim krijimi të këstit të paguar për këtë pasuri nga subjekti në vitin 2004.

Komisioni, sikurse ka arsyetuar edhe në pasuritë e sipërpërmendura lidhur me *marzhën* e mundshme të fitimit të bashkëshortes së subjektit për periudhën përpara vitit 2007, kohë në të cilën në nivel zyrtar konfirmohet vetëm qarkullimi i saj, ka vlerësuar dhe ka përlllogaritur me objektivitet të ardhurat e përfituara sipas *marzhave* të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në masën 75 % dhe 70 %, nga 70% dhe 60% që ishte përlllogaritur më parë.

Pas kryerjes së analizës financiare me rillogaritjet e bëra, nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisionit i ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të shlyer këstet e kredisë deri në vitin 2008.

Lidhur me deklarin e burimit të krijimit të kësaj pasurie trupit gjykues i rezulton se subjekti shumën e depozitës 1.500.000 lekë e ka përdorur si burim për një tjetër destinacion, blerje aparature dentare, e pranuar edhe prej tij dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë deklarin e burimit të saj në deklaratën “Vetting”.

Lidhur me deklarin e subjektit gjatë hetimit administrativ se për këtë pasuri është përdorur depozita, nr. (***), në ish-“Bankën e Kursimeve”, në shumën 200.000 lekë, e deklaruar në deklaratën për vitin 2004, trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ka deklaruar përdorimin e depozitës nr. (***).

Në konkluzion:

- ✓ Trupi gjykues, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe shqyrtimin e rrethanave në tërësi të kësaj pasurie, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë (deklarata “Vetting”), për deklarin e burimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimet ligjore në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

→ Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1.500.000 lekë, dhënë nga kunati i subjektit, shtetasi A. S. (vëllai i bashkëshortes së subjektit) në vitin 2003.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

Komisionit, gjatë hetimit administrativ, i rezultoi se:

- Subjekti, në deklaratën për vitin 2003, ka deklaruar *se kjo shumë i përket pasurisë klinike dentare në Kuçovë, e cila i ishte shitur kunatit të tij, por çmimi i shitjes nuk ishte likuiduar dhe kontrata e shitjes nuk ishte bërë ende.*
- Subjekti, në përgjigje të pyetësorit²⁴, ka depozituar shkresën “Kontratë huaje” nr. (***), datë 19.9.2002, hartuar para noteres A. B., Kuçovë, me palë huadhënëse z. A. S. dhe palë huamarrëse z. Gurali Brahimllari, për shumën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, pa interes, me afat trevjeçar, për të cilën ka deklaruar: *“...qëllimi i vërtetë i palëve ishte pagesa e pjesshme e vlerës së klinikës nga huadhënësi (blerësi), shitja e së cilës do të realizohej pas zgjidhjes së problematikës së truallit, që jo vetëm nuk varej nga huamarrësi (shitësi), por nga ndryshimet ligjore, të cilat zgjatën për shumë vjet, duke u lejuar shitblerja e trojeve shtetërore vetëm gjatë vitit 2012 e në vijim, pra, tej afatit që u mendua në kohën e lidhjes së kontratës së huas”.*
- Subjekti e ka deklaruar këtë shumë të përfutur si pagesë e kështit të parë të shitjes së ish-klinikës dentare në Kuçovë.
- Shitja e kësaj pasurie ishte realizuar në vitin 2012 dhe, për të provuar vërtetësinë e këtij fakti, subjekti ka depozituar edhe kontratën përkatëse.

- Komisioni e ka pyetur²⁵ subjektin lidhur me ligjshmërinë e burimit të kësaj shume, si dhe i ka kërkuar të paraqesë dokumentacionin justifikues për vërtetësinë e deklaramit.

- Në përgjigjen e tij, subjekti ka cituar: *“...shuma e marrë hua nga kunati, z. S. është depozituar në datën 23.10.2003, në “Alpha Bank” në emër të bashkëshortes ...në lidhje me aftësinë paguese të kunatit, A. S. (alias B. V.), deklaroj se ka emigruar në Greqi që në vitin 1991, fillimisht në qytetin e Larisës, ku u punësua në një dyqan lulesh, e më pas rreth vitit 1994... ka qëndruar në mënyrë permanente në Greqi në vendet e sipërcituara... Ai dhe familja e tij kanë ndërtuar ekonominë e tyre me punë, por si edhe shumë shqiptarë që punojnë e jetojnë në emigracion..., A. ka punuar kryesisht në ndërtim (përfshirë edhe në rikonstruksionin a ndërtimin e objekteve të kultit), sepse është specializuar për shtrimin e mermerit e, në veçanti si “rashinues”... Kjo natyrë e punës së tij ka qenë dhe është e tillë që kërkon punësim me disa ditë, në objekte të ndryshme e në punëdhënëse të ndryshëm, të cilët, ndonëse e kanë paguar mirë, jo rrallëherë nuk kanë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore-shëndetësore. ...Me kërkesën time të muajit dhjetor, A. ka mundur të sigurojë e më ka dërguar një pjesë të vogël të të ardhurave, për të cilat ka qenë i siguar, duke më sqaruar se deri në fund të vitit 2001, në Greqi nuk gjenden të dhënat e punësimit në sistem elektronik. Ai nuk ka mundur të gjejë as trashëgimtarët e punëmarrëses në dyqanin e luleve në Larisa, Greqi, ndërsa për periudhën janar 2002 e në vijim, ka gjetur të dhëna në Institutin e Sigurimeve Shoqërore & Solidaritetit Social, me seli në Agios Stefanos.”*

- Së bashku me deklaramet e tij subjekti ka depozituar:

- Ilogaritje të të siguarit A. S. me regjistrime të papërfunduara), me numër amze nga sigurimet shoqërore për periudhën kohore nga 1/2002 deri në fund me vulë Apostile të datës 27.12.2018;
- vërtetimin për gjendjen gjyqësore të shtetasit A. S. nga organi kompetent shtetëror në Greqi, i vërtetuar nënshkrimi nga noterja në datën 31.1.2019.

²⁴ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 19, në pyetësorin nr. 2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 19, në pyetësorin nr. 2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit, si dhe përgjigjeve të pyetësorit datë 11.4.2019, në dosjen e Komisionit.

- Komisioni, nga verifikimi dhe analizimi i dokumenteve, më konkretisht nga llogaritjet e të siguruarit V., ka konstatuar se për vitin 2002 ky i fundit ka deklaruar në shtetin grek të ardhura nga punësimi në shumën 5.430,21 euro.

- Në këto kushte, Komisionit i rezultoi se dokumentacioni i depozituar nga subjekti për vitin 2002 nuk ishte i mjaftueshëm për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë nga shtetasi V., në raport me shpenzimet e jetesës për këtë vit (2002), dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën për arsye se: *dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 1.500.000 lekë, dhënë hua; dukej se kishte mungesë të dokumentacionit justifikues për të provuar dhënien e kësaj shume.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e tij, vijon të mbajë të njëjtin qëndrim sikurse është shprehur edhe gjatë hetimit administrativ, se kunati i tij ka krijuar të ardhura nga punësimi në emigracion në shtetin grek, ku *jo rrallëherë nuk kanë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore-shëndetësore*. Subjekti depozitoi disa fotografi ku shfaqeshin ambiente të ndryshme të veshura me mermer, të pretenduara se pasqyrojnë punime të kryera prej tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në lidhje me sigurimet shoqërore të paguara për huadhënësin në shtetin grek, ka konstatuar se konfirmohen pagesa të sigurime shoqërore të të ardhurave për vite të ndryshme kalendarike. Nga verifikimi përkatës Komisioni ka vlerësuar të ardhurat e tatuara sipas formularit mbi përlllogaritjet e të siguruarit shtetasit S., ku rezulton se për vitin 2002, ky i fundit ka përfituar të ardhura nga punësimi në shumën 5.430,21 euro, shumë kjo që nuk përkon me shumën e dhënë nga shtetasi A. S. . Dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk provon mjaftueshmërinë e burimit të ligjshëm të shumës së dhënë hua, sikurse kërkohet nga pika 3, e nenit D, e Aneksit të Kushtetutës dhe pika 1, e nenit 32, e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilëve subjekti dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin jo vetëm të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tyre, por edhe të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve të tyre për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se edhe fotot e depozituara nga subjekti nuk provojnë burimin e krijimit të të ardhurave të huadhënësit.

Trupi gjykues arrin në konkluzion se:

✓ Subjekti nuk arriti të provojë²⁶ me dokumentacion burimin e ligjshëm të shumës 1.500.000 lekë, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

➔ Në lidhje me pasurinë e krijuar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në vitin 2008 e në vijim.

4. Në lidhje me pasurinë apartament nr. (*)**, me sip. 250 m², me garazh e papafingo, sipas kontratës së porosisë nr. (***), datë 5.1.2010 (*e cila referon në kontratën nr. (***)*, datë 20.4.2009, por e nënshkruar nga palët në datën 13.12.2008), me sipërfaqe banimi 180 m², e regjistruar në ZRPP-në në emër të firmës “M.” sh.p.k. si pasuria nr. (***), vol. (***), f. (***), në z.k. (***), S., Tiranë, me vlerë të financuar sipas kontratës 160.000 euro, e pasqyruar edhe në seksionin “D” të pasurisë nr. (***), paguar me këste (*viti 2008: 49.000 euro, viti 2009:*

²⁶ Pika 18 e udhëzimit nr. 4095/2016 parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e [...] huadhënësit [...] detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit.”

91.000 euro dhe në vitin 2010 u financua 20.000 euro), me vendndodhje: radha III e kompleksit “M.”, në rrugën “(***)” (rrugë e fshatit “(***)”).

4.1 Në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar se pas marrjes në dorëzim nga firma ndërtuese janë kryer punime shtesë me financimin e tij, është bërë arredimi i brendshëm dhe, në korrik 2012, familja e tij është vendosur të banojë në këtë apartament.

4.2 Burimi i deklaruar i krijimit:

- a) Paga e subjektit si gjyqtar dhe nga aktiviteti i klinikës dentare të bashkëshortes, znj. L. B., gusht 2008 – dhjetor 2016 (e në vijim për pagesën e kredisë së marrë për këtë qëllim).
- b) Dy kredi në ish-“Bankën Popullore” (sot banka “Societe Generale Albania”) në total 75.000 euro: në datën 1.6.2009 është marrë vlera 50.000 euro (kaluar firmës me bankë) dhe në datën 16.12.2010, vlera 25.000 euro.
- c) Shitja e pasurisë nr. (***), me sipërfaqe 38.25 m² (ish-klinika dentare Kuçovë, ndërtuar sipas lejes sheshndërtimi nr. (***), datë 14.2.1995, e lejes së ndërtimit nr. (***), datë 30.3.1995, në funksion të punës si dentiste të bashkëshortes, në qershor 1995), me kontratën nr. (***), në datën 27.12.2012, së bashku me truallin 38.25 m² (i cili u ble nga subjekti me kontratën nr. (***), datë 14.8.2012). Çmimi 4.000.000 lekë i shitjes së ish-klinikës dentare, prej të cilave 1.500.000 lekë ishin paguar nga blerësi, z. A. S., në tetor 2003 (deklaruar në mars 2004), ndërsa pjesa e mbetur u kompensua në vlerën 19.000 euro, marrë hua në dhjetor 2008, për apartamentin në Sauk. Punimet suplementare për vitin 2011 – 2012 janë në vlerën 2.000.000 lekë dhe arredimi përgjatë periudhës 2012 – 2016 në vlerën 2.100.000 lekë.

4.3 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.²⁷

- ILDKPKI-ja në konkluzionin e saj është shprehur se:
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 si burim për blerjen e këtij aseti subjekti ka deklaruar se ka marrë hua me qëllim kryerjen e pagesës ndaj “M.”, shumën 19.000 euro nga kunati, z. A. S. alias B. V., si dhe shumën 2.000.000 lekë nga i vëllai, B. B., të cilat nuk i ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe analitike në deklaratën “Vetting” (sa më poshtë në rubrikën e detyrimeve).
- Subjekti nuk justifikon me dokumentacion ligjor burimin financiar të kunatit, z. B. V., për huan e marrë prej tij në shumën 19.000 euro, si dhe shumën 2.000.000 lekë marrë nga i vëllai, z. B. B. .
- Konstatohet se deri në vitin 2008 z. B. B. nuk ka tërhequr dividend nga shoqëria e tij, “E.” sh.p.k. (shoqëria tjetër “I.” sh.p.k., është regjistruar në vitin 2011), ndërsa shtetasi tjetër, z. B. V., nuk rezulton me aktivitet tregtar, çka ngre dyshime mbi mundësinë financiare për të kursyer shumat e huave të dhëna (kjo pasi nuk ka informacion tjetër mbi të ardhurat e këtyre shtetasve).
- Në deklaratën periodike vjetore 2009 subjekti ka deklaruar se i ka marrë përsëri hua të vëllait, z. B. B., një shumë prej 10.000 eurosh dhe të vëllait tjetër, z. P. B., një shumë prej 2.000.000 lekësh. Edhe këto hua subjekti nuk i ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe analitike në deklaratën “Vetting” (as më poshtë në rubrikën e detyrimeve).
- Subjekti nuk e justifikon me dokumentacion ligjor burimin e shumave prej 10.000 eurosh dhe 2.000.000 lekësh, marrë hua prej vëllezërve të tij.
- Konstatohet se shoqëria “E.” sh.p.k., ku i vëllai, z. B. B., është ortak i vetëm që prej regjistrimit të saj në vitin 2009, ka shpërndarë dividend në shumën 1.200.000 lekë, por kjo

²⁷ Kontratë porosie datë 13.12.2008, për pasuri e llojit vilë me dy kate + papafingo, me sip. ndërtimore 208 m², me sip. banimi 160 m², etj.; shkresë kthim përgjigjeje, datë 15.3.1995, nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Kuçovë për znj. L. B., vendim kryetari i Këshillit të Rrethit Kuçovë, për dhënie shesh-ndërtimi nr. (***), datë 14.2.1995, për sheshin e ndërtimit me sip. 24 m²; kërkesë për leje ndërtimi nga znj. L. B., datë 17.2.1995 (aneks. nr. 4/6) i ILDKPKI-së.

shumë është e pamjaftueshme për të mbuluar huadhënien e tij prej 10.000 eurosh. Për sa i përket të vëllait tjetër, z. P. B., rezulton se shoqëria “E.” sh.p.k., ku ai është ortak vetëm në vitin 2009 ka shpërndarë dividend, por ai ka qenë veçse 25.024 lekë, shumë kjo e pamjaftueshme për të mbuluar huadhënien e tij prej 2.000.000 lekësh, çka ngre dyshime mbi mundësinë financiare të tyre për të kursyer shumat e dhëna hua (kjo pasi nuk ka informacion tjetër mbi të ardhurat e këtyre shtetasve).

- Subjekti, në rubrikën e detyrimeve, deklaroi se kredia e dytë prej 25.000 eurosh, efektivisht ka shlyer këstin e fundit të kontratës së porosisë për shtëpinë në Sauk ndaj firmës “M.” sh.p.k., ndonëse kjo e fundit ishte likuiduar para lëvrimin të kësaj kredie sipas afatit të caktuar në kontratën e re të porosisë së datës 5.1.2010 me huan e marrë nga vëllezërit, prandaj dhe vlera e kredisë ka kaluar në llogarinë e të vëllait, z. B. B., por referuar deklaratës së vitit 2010 nuk rezulton që subjekti ta ketë deklaruar këtë veprim.
- Shlyerja e huas prej 10.000 eurosh ndaj të vëllait, B. B., kryer në “SGA Bank” në vitin 2013 është deklaruar me burim nga “Alpha Bank”, por në deklaratën e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar ta ketë pakësuar këtë shumë në “Alpha Bank”.
- Subjekti nuk ka deklaruar gjeneralitetet e plota të huadhënësve.
- Me kontratën e porosisë datë 13.12.2008 është porositur vila me 2 kate + papafingo me sip. totale ndërtimore 208 m² dhe me sip. banimi 160 m², me çmimin 160.000 euro.
- Me kontratën e porosisë datë 5.1.2010, konstatohet se ka ndryshuar vila dhe sipërfaqja e saj, por çmimi ka mbetur po i njëjtë, konkretisht është porositur vila me 3 kate + papafingo me sipërfaqe totale ndërtimore 250 m² dhe me sipërfaqe banimi 180 m².
- Mbetet i dyshimtë çmimi i blerjes së vilës, i cili mbetet i njëjtë edhe pas ndryshimit/rritjes së sipërfaqes, por edhe si çmim për/m² në tërësi.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

4.5 Komisioni hetoi lidhur me ekzistencën e kësaj pasurie²⁸ dhe, nga hetimet, rezultoi se kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, në shumën 160.000 euro.

4.6 Komisioni hetoi lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, nga ku i rezultoi se:

- Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar pagën e tij si gjyqtar dhe të ardhurat nga aktiviteti i klinikës dentare të bashkëshortes, znj. L. B. për periudhën gusht 2008 – dhjetor 2016 (*e në vijim për pagesën e kredisë së marrë për këtë qëllim*).
- Ndërsa, në deklaratën për vitin 2008 subjekti ka deklaruar se ka lidhur kontratë porosie datë 13.12.2008, me firmën ndërtuese “M.”, për një apartament në Sauk, pranë fshatit S. dhe se kishte paguar këstin e parë në shumën 49.000 euro, me burim krijimi:
 - i) **hua e marrë** pa interes nga shtetasi A. S. (vs) B. V., vëllai i bashkëshortes së tij, në shumën 19.000 euro, kaluar nga llogaria e tij bankare në “Alpha Bank” për shoqërinë ndërtuese “M.”. Për këtë veprim subjekti ka deklaruar se marrëveshjet kanë qenë gojore, pa afat shlyerjeje, por se do të shlyheshin me kredi ose nga shitja e objektit në rrugën “(***)”;
 - ii) **hua e marrë** pa interes nga vëllai i tij, shtetasi B. B., në shumën 2.000.000 lekë, si depozitë e tij në “Tirana Bank”. Për këtë veprim subjekti ka deklaruar se marrëveshjet kanë qenë gojore, pa afat shlyerjeje, por se do të shlyheshin me kredi ose nga shitja e objektit në rrugën “(***)”.
- Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se subjekti në deklarimet ndër vite prej momentit të porositjes së kësaj pasurie (2008), ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri huat e marra nga vëllezërit e tij, si dhe nga i kunati, z. A. S. .

²⁸ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 7.1.2019, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

4.7 Nisur nga këto deklaratime kontradiktore Komisioni e ka pyetur²⁹ subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, në përgjigjet e të cilave ai ka shpjeguar se huat kanë qenë në funksion të likuidimit së shumës për blerjen e kësaj pasurie.

4.8 Komisionit, gjatë hetimit administrativ, i rezultoi se burimi i deklaruar në deklaratën për “Vetting” ka shërbyer për shlyerjen e huave.

4.9 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të pagesës së kësaj pasurie në shumën 49.000 euro, në vitin 2008.

4.10 Siç është përsëritur më sipër, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për këtë shumë kanë shërbyer huat e marra pa interes nga kunati i tij, shtetasi V., dhe i vëllai i tij, shtetasi B. B., përkatësisht shumat 19.000 euro dhe 2.000.000 lekë.

4.11 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 19.000 euro, Komisionit i rezultoi se kjo shumë ishte kaluar me transaksion bankar nga llogaria bankare e huadhënësit në “Alpha Bank” për llogari të firmës ndërtuese “M.” sh.p.k., në datën 4.12.2008.

4.12 Subjekti, sikurse ka deklaruar për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 1.500.000 lekë (për të cilën është arsyetuar më sipër), edhe në këtë rast ka sqaruar³⁰ se edhe këto të ardhura nga kunati i tij janë krijuar përmes punës në emigracion në shtetin grek, ku jeton së bashku me familjen e tij prej vitit 1991, dhe se pjesën më të madhe të të ardhurave ai e ka nga puna e ndershme, por e pasiguar. Ndër të tjera ka cituar: “...jo rrallëherë nuk kanë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore-shëndetësore.” ... se të ardhurat e kunatit dhe të familjes së tij në atë periudhë e në vijim përfshijnë edhe të ardhurat e përfuara nga bashkëshortja, znj. K. S., e cila, ashtu si pjesa më e madhe e grave shqiptare, punon si shtëpiake, në ditë të ndryshme të javës, në shtëpi të pronarëve grekë, por e pasiguar...

4.13 Subjekti ka depozituar:

- llogaritje të të siguruarit, z. A. S. (me regjistrime të papërfunduara) për periudhën kohore nga 1/2002 deri në fund me vulë Apostile të datës 27.12.2018;
- vërtetimin për gjendjen gjyqësore të shtetasit A. S. nga organi kompetent shtetëror në Greqi, i vërtetuar nënshkrimi nga noterja në datën 31.1.2019.

4.14 Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar për huadhënësin, Komisionit i rezultoi se të ardhurat e siguruar nga punësimi në shtetin grek për periudhën 2003 – 2007 ishin rreth 23.000 euro, shumë e cila nuk rezulton të jetë e mjaftueshme edhe për të dhënë hua dhe për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën: se *dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 19.000 euro, dhënë hua, dhe dukej se kishte mungesë të dokumentacionit justifikues për të provuar krijimin e kësaj shume.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e tij, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse është shprehur edhe gjatë hetimit administrativ, se kunati i tij ka krijuar të ardhurat nga puna e ndershme, por e pasiguar në shtetin grek. Ndër të tjera ka cituar: “...në fakt, të ardhurat e siguruar nga puna e tij e ndershme dhe e vështirë, posaçërisht në periudhën 1999 – 2008, kanë qenë të kënaqshme, por punëmarrësit grekë shpeshherë nuk kanë paguar kontributet shëndetësore e shoqërore të tij... Kunati ka punuar rreth 27 vjet në Greqi dhe se nga puna e tij dhe e bashkëshortes së tij kanë siguruar të ardhura të atij niveli që e justifikojnë, tej çdo dyshimi, aftësinë paguese të tyre për krijimin e vlerave monetare kanë shërbyer për blerjen e klinikës në Kuçovë (1.500.000 lekë + 19.000 euro të konvertuara së bashku në çmimin e blerjes së pasurisë me sip. 38.25 m² së

²⁹ Referojuni pyetësorëve datë 24.1.2019 dhe datë 26 mars 2019 në dosjen e Komisionit.

³⁰ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 19, në pyetësorin nr. 2, datë 4.2.2019, në dosjen e Komisionit.

bashku me truallin). Subjekti depozitoi disa fotografi ku shfaqeshin mjedise të ndryshme të veshura me mermer, për të cilat pretendonte se pasqyronin punime të kryera prej tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni, sikurse ka analizuar më sipër për shumën 1.500.000 lekë dhënë hua nga shtetasi A. S., si dhe lidhur me vërtetësinë e burimit të ligjshëm të huas në shumën 19.000 euro, analizoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në lidhje me sigurimet shoqërore të paguara për të në shtetin grek, nga ku ka konstatuar se për një periudhë katërvjeçare, përkatësisht 2003 – 2007, shtetasi A. S. ka përfituar të ardhura nga punësimi në shumën rreth 23.000 euro, shumë e cila nuk rezulton të jetë e mjaftueshme për të provuar burimin e ligjshëm të huas.

Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se fotot e depozituara nga subjekti, nuk mund të shërbejnë si prova për të provuar burimin e krijimit të të ardhurave të huadhënësit. Në tërësi dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk provon plotësisht burimin e krijimit të shumës së dhënë hua, sikurse kërkohet nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 1 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues burimin e ligjshëm të shumës 19.000 euro, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

4.15 Në lidhje me huan e marrë³¹ vëllait të tij, shtetasit B. B., në shumën 2.000.000 lekë, subjekti ka deklaruar se ...vlerën prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh vëllai e ka dhënë hua në 23 dhjetor 2008... Për këtë subjekti ka depozituar *statement* të llogarisë personale të shtetasit B. B. në “Tirana Bank”, ku në datën 23.12.2008 rezulton se ky i fundit ka tërhequr depozitën në shumën 1.945.600 lekësh, por pa përshkrim.

4.16 Në përgjigje të pyetësorit³² subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. 7341/2407, datë 21.12.2009, sipas së cilës vëllai i tij, B. B., i ka dhënë hua shumën 2.000.000 lekë për një afat 5-vjeçar pa asnjë interes.

4.17 Komisioni e ka pyetur³³ subjektin lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume të dhënë hua.

4.18 Me përgjigjet e pyetësorit datë 26.3.2019, subjekti ka deklaruar: “*Burimi i krijimit të huas ka qenë kryesisht pjesë e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “E.” sh.p.k., që pasqyrohen në të dhënat bankare në “Tirana Bank”*”, si dhe ka depozituar:

- *statement* të llogarisë bankare në “Tirana Bank” të kompanisë “E.” sh.p.k., ku në datën 3.4.2006 është kryer transaksioni i tërheqjes së shumës 1.750.000 lekë nga z. B. B.;
- *statement* të llogarisë personale të shtetasit B. B. në “Tirana Bank”, ku në datën 23.12.2008 është tërhequr depozita e krijuar në datën 3.4.2006, në shumën 1.945.600 lekë.

4.19 Sipas *statement*-it të llogarisë bankare në “Tirana Bank” të kompanisë “E.” sh.p.k., Komisionit i rezultoi se shuma prej 1.750.000 lekësh është tërhequr fillimisht nga huadhënësi nga kjo kompani në datën 3.4.2006 dhe më pas kjo shumë është kaluar në llogarinë personale të tij në “Tirana Bank”. Në datën 4.4.2006 me këtë shumë rezulton se huadhënësi ka çelur një depozitë me afat.

³¹ Në datën 23.12.2008, sipas deklaratës noteriale nr. (***), datë 21.12.2009, në dosjen e Komisionit, si dhe deklaratës nr. (***), datë 24.12.2013, në dosjen e Komisionit, sipas të cilës është shlyer shuma 1.000.000 lekë e huas prej 2.000.000 lekësh.

³² Referojuni dokumenteve të bashkëngjitura me përgjigjet e pyetësorit datë 26.3.2019, në dosjen e Komisionit.

³³ Referojuni përgjigjes nr. 1 të pyetësorit, datë 26.3.2019, në dosjen e Komisionit.

4.20 Gjithashtu, Komisionit i rezultoi se sipas *statement*-it të llogarisë personale të huadhënësit, shtetasit B. B., në “Tirana Bank”, në datën 23.12.2008, ky i fundit ka tërhequr depozitën e lartpërmendur, së bashku me interesat e përfituara nga momenti i krijimit (datë 4.4.2006) deri në momentin e tërheqjes, në shumën 1.945.600 lekë. Kjo tërheqje ka rezultuar pa përshkrim.

4.21 Nga hetimi, Komisionit i rezultoi se në ndryshim nga veprimet që huadhënësi ka kryer lidhur me tërheqjen e shumës nga kompania e tij, në deklaratën noteriale nr. (***) , datë 21.12.2009³⁴, ka deklaruar si burim të saj “*kursimet e tij në “Tirana Bank”, me numër llogarie (***)*”.

4.22 Nisur nga fakti se transaksionet bankare për këtë huadhënie janë kryer nga kompania “E.” sh.p.k., Komisioni e shtriu hetimin e tij lidhur me vërtetësinë e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, duke kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si edhe te vetë kompania.

4.23 Me shkresën nr. (***) prot., datë 7.1.2019, DRT-ja Tiranë informoi Komisionin mbi fitimin *neto* të kompanisë “E.” sh.p.k., me NIPT (***) , ku administrator dhe aksioner i kësaj kompanie ishte i vëllai i subjektit, shtetasi B. B. . Nga informacioni i dërguar, kompania rezultonte me fitim nga viti 2001 e në vazhdim, por shpërndarja e dividendit kishte filluar vetëm në vitin 2009, ndërsa huaja i është dhënë subjektit në vitin 2008.

4.24 Për faktin se shuma e dhënë hua është tërhequr nga llogaria e kompanisë, vit (2006) në të cilin nuk rezulton të jetë shpërndarë dividend, Komisioni i ka kërkuar DRT-së Tiranë pasqyrat financiare për vitet 2006 deri në 2010 për të verifikuar se si pasqyrohet llogaria e ortakut.

4.25 Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Tiranë³⁵, rezultoi se në pasqyrat financiare për vitin 2006 llogaria e ortakut të kësaj shoqërie rezultonte pa detyrime.

4.26 Gjithashtu, kompania “E.” sh.p.k.³⁶ ka depozituar bilancet e shoqërisë në të cilën pasqyrohet i njëjti fakt, si edhe nga DRT-ja Tiranë, se llogaria e ortakut për vitin 2006 nuk rezultonte të kishte detyrime.

4.27 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të depozituar si nga subjekti, ashtu edhe nga korrespondenca e mbajtur gjatë hetimit administrativ me institucionet dhe me kompaninë “E.” sh.p.k., Komisionit i rezultoi se: *dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i shumës 2.000.000 lekë, dhënë hua nga shtetasi B. B., pasi nuk rezultonte që shoqëria të kishte shpërndarë dividend në vitin 2008; dukej se kishte mospërputhje midis deklarimeve të subjektit në pyetësor, deklaratës noteriale nr. (***) , datë 21.12.2009, se burimi i krijimit të huas në shumën 2.000.000 lekë ishte pasojë e kursimeve në bankë, me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, nga ku rezultoi se kjo shumë ishte tërhequr fillimisht nga llogaria e kompanisë së huadhënësit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti ndër të tjera ka pretenduar se burimi i ligjshëm i të ardhurave të një ortaku shoqërie të suksesshme nuk lidhet vetëm me mënyrën e disponimit të dividendit. Sipas pasqyrave financiare dhe të dhënave të Drejtorisë së Tatimeve Tiranë provohet bindshëm se jo vetëm në tërësi, por edhe për çdo vit ushtrimor të aktivitetit firma “E.” sh.p.k. ka qenë me fitime. Subjekti ka kërkuar marrjen si provë edhe të disa dokumenteve të tjera ligjore të të vëllait, z. B. B., që lidheshin kryesisht me pagën e tij si administrator dhe atë të bashkëshortes së tij, e punësuar në të njëjtën shoqëri, dhe për këtë ka depozituar:

³⁴ Depozituar me pyetësorin datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 18.4.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Shkresë datë 27.4.2019 dhe dokumentacioni bashkëngjitur i shoqërisë “E.” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

- formularë për pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajt janar e qershor 2007, si dhe për muajt janar 2008, janar 2009, janar 2010, janar 2011 dhe janar 2012.
- certifikatën familjare të të vëllait, z. B. B., lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Njësisë Bashkiake nr. 2, në datën 27.5.2019.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar, në raport me shpjegimet e subjektit, vlerëson se pretendimi i tij në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë të dhënë hua nga i vëllai, me cilësinë e personit tjetër të lidhur, se ka si burim krijimi kursimet e këtij të fundit, nuk qëndron për faktin e konstatuar nga transaksioni bankar, se kjo shumë është tërhequr nga llogaria e kompanisë. Për këtë shkak subjekti duhet të provonte pagesën e tatimit për këtë shumë të tërhequr nga vëllai i tij. Komisioni nuk ka vënë në diskutim faktin nëse kompania e administruar nga vëllai i subjektit ka pasur ose jo të ardhura të mjaftueshme, likuiditete të disponueshme apo fitim *neto* për t'ia vënë në dispozicion subjektit, por është përqendruar te detyrimi që vëllai i tij ka pasur për të paguar tatimin mbi çdo shumë të përfituar nga fitimi i shoqërisë. Më konkretisht rezultoi se shuma e tërhequr nga kompania në vitin 2006 nuk është pasqyruar si një huamarrje e ortakut ndaj kompanisë. Dokumentacioni i dorëzuar nuk ka nivelin e provueshmërisë, pasi transaksioni i huamarrjes është kryer nga llogaria e biznesit të tij dhe jo nga llogaria personale. Pavarësisht se biznesi rezulton me fitim, nuk provohet tatimi i paguar i këtyre të ardhurave, nuk është shpërndarë dividend³⁷ dhe në bilancet e shoqërisë kjo shumë nuk rezulton si hua në zërin "*llogaria e ortakut*" të pasqyrave financiare.

Për shkaqet e arsyetuara më sipër, Komisioni vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk përbën provë për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua, pasi kursimet nga pagat e huadhënësit dhe të bashkëshortes së tij nuk kanë qenë burim i saj.

Trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm, sipas nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi B. B. .

4.28 Nga verifikimi i kontratës së porosisë³⁸ për këtë pasuri, datë 13.12.2008, me çmim blerjeje 160.000 euro, parashikohej se:

- në datën e lidhjes së kësaj kontrate (13.12.2008) është paguar shuma 29.000 euro;
- deri në datën 31.12.2008 paguhet shuma 20.000 euro;
- brenda datës 15.1.2009 paguhet shuma me vlerë 16.000 euro;
- brenda datës 31.3.2009 paguhet shuma 15.000 euro;
- brenda datës 30.4.2009 paguhet shuma 50.000 euro.

4.29 Komisionit i rezultoi se për këtë pasuri, ndryshe nga sa parashikohej në kontratën e porosisë, ishte paguar:

- nga kunati i subjektit (me cilësinë e huadhënësit) me transaksion bankar, në datën 4.12.2008, shuma 19.000 euro;
- nga bashkëshortja e subjektit, *cash*, e vërtetuar³⁹ nga shoqëria "M." sh.p.k. , në datën 16.10.2008, shuma 20.000 euro;

³⁷ Pika 22 e udhëzimit nr. 4095/2016 parashikon: "*Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.*"

³⁸ Referojuni aneksit nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹ Referojuni vërtetimeve datë 16.10.2008 dhe 18.10.2008, aneksi nr. 45, në dosjen e ILDKPKI-së.

- nga bashkëshortja e subjektit, *cash*, e vërtetuar nga shoqëria “M.” sh.p.k. , në datën 18.10.2008, shuma 10.000 euro.

4.30 Gjatë hetimit administrativ Komisionit i rezultoi se pagesat e kryera nga bashkëshortja e subjektit në tetor 2008 ishin kryer përpara marrjes së dy huave për të cilat u arsyetua më sipër, në ndryshim nga deklarimi i bërë nga subjekti se si burim për këtë pasuri për këstet e vitit 2008 kishin shërbyer dy huat.

4.31 Pas këtij konstatimi, Komisioni e ka pyetur⁴⁰ subjektin e rivlerësimit për të cilën ai ka cituar shprehimisht: “...në datën 18 tetor 2008 kemi dhënë si kapar shumën 10.000 euro të përbërë nga dy depozita në llogarinë e bashkëshortes në “Alpha Bank”, ndërsa shumën 20.000 euro bashkëshortja ia ka shlyer në një nga ditët e fundit të dhjetorit 2008 administratores së firmës sipërmarrëse në mjediset e klinikës dhe se dokumenti shkresor për këtë pagesë nuk është nënshkruar në momentin e dorëzimit, por disa kohë më pas, prandaj data e vendosur në dokumentin që Komisioni citon, përbën *lapsus*...”

4.32 Komisioni, në vlerësim të provave, konkretisht të vërtetimeve të nënshkruara nga bashkëshortja e subjektit për llogari të shoqërisë ndërtimore, të kontratës së porosisë nënshkruar për këtë pasuri dhe të deklarimeve të subjektit, kreu analizën financiare lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 30.000 euro të paguar në muajin tetor 2008:

	Periudha	1.1.2008 – 18.10.2008
	Pasuri	2 643 825
	Dy këstet për blerjen e vilës	3 695 475
	Ndryshim likuiditete	(1 051 650)
	Detyrime	(2 835 332)
	Kredi bankare në “Alpha Bank” për klinikën 79 m ² (datë 12.5.2005) (50.000 euro)	(2 835 332)
(1)	Pasuri neto (Pasuri – detyrime)	5 479 157
(2)	Të ardhura	2 590 117
	Të ardhura nga paga, subjekti, deri më 18.10.2008	870 939
	Të ardhura, bashkëshortja	1 552 111
	Interesa bankare	167 067
(3)	Shpenzime	914 279
	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	455 400
	Shkollimi i djalit, universiteti “L.”	246 365
	Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	40 650
	Interesa Kredi në “Alpha Bank” për klinikën 79 m ² (datë 12.5.2005) (50.000 euro)	171 864
	Analiza (2 – 3 –1)	(3 803 320)

nga ku rezultoi se: *dukej se subjekti kishte kryer deklarim të rremë lidhur me burimin e krijimit të këstit prej 49.000 eurosh në vitin 2008 për këtë pasuri, pasi nuk kishte deklaruar dy këstet e paguara në muajin tetor 2008 në shumën 30.000 euro; dukej se huaja e marrë nga i vëllai i tij, B. B., në shumën 2.000.000 lekë në dhjetor të vitit 2008 nuk kishte pasur destinacion burimin e krijimit të shumës 49.000 euro si këst i paguar për këtë pasuri në vitin 2008; Dukej se subjekti nuk kishte pasur burime të ligjshme në shumën 3.803.320 lekë për të paguar këstet më 16 dhe 18 tetor 2008 për këtë pasuri, si dhe për të kryer shpenzimet deri në muajin tetor 2008 dhe, për pasojë, i kaloi atij barrën e provës për të provuar të kundërtën.

⁴⁰ Referojuni pyetësorit datë 11.4.2019, në dosjen e Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, në prapësimet e tij, ka pranuar se ka paguar në tetor 2008 shumën 10 000 euro dhe se për to ka pasur burime të ligjshme që rridhnin nga kursimet në bankë të vitit 2007 në depozitë, në emër të bashkëshortes, të plotësuar me të ardhurat e periudhës gusht – tetor 2008.

Subjekti ka sqaruar se pjesë e pagesës së kryer në vitin 2008 është edhe pagesa nëpërmjet bankës në shumën 19.000 euro dhe pjesa tjetër në shumën 20.000 euro, e paguar në dhjetor 2008, e krijuar nga depozita në vlerën 10.300 euro në “Bankën Amerikane”, si dhe nga huaja në vlerën 2.000.000 lekë e të vëllait, B. B. .

Subjekti ka pretenduar se në likuidimin e kështit për vitin 2008 në shumën 49.000 euro duhet të merren në konsideratë, përveç huave të marra, edhe të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortëve. Më konkretisht subjekti ka cituar “...për pjesën e paguar gjatë vitit 2008, në shumën 49.000 euro sipas deklaratimit të mësipërm në deklaratën “Vetting”, duhet të përfshihen edhe të ardhurat nga “Paga e subjektit si gjyqtar dhe nga aktivitetet i klinikës dentare të bashkëshortes L.”, për periudhën gusht 2008 – dhjetor 2008 apo likuiditetet që ne kishim të lira apo posedonim në këtë hark kohor”. Subjekti pranon se është paguar shuma 10.000 euro në datën 18 tetor, duke cituar shprehimisht: “...për pagesën prej 10.000 eurosh deklaroj se kam pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e tyre” dhe më konkretisht ai ka cituar: “...sjell në vëmendje deklaratat e viteve 2007 dhe 2008, të dorëzuara në ILDKPKI, në mars të viteve pasardhës, ku kam deklaruar, krahas të tjerave, edhe krijimin/çeljen, në emër të bashkëshortes L., të dy depozitave, respektivisht në datën 17.5.2007 (në shumën 500.000 lekë) dhe në datën 15.9.2007 (në shumën 451.523 lekë); ndërsa në emrin tim, në “Bankën Amerikane”, krijimin/çeljen e depozitës së datës 11.12.2007 (në shumën 10.000 euro). Rezulton se këto vlera monetare janë tërhequr nga bankat përkatëse dhe janë përdorur si likuiditete për pagesën e kësteve të kontratës së sipërmarrjes së pasurisë në vitin 2008, sepse sipas gjendjes së këtyre depozitave e kohës së mbylljes/tërheqjes së tyre, rezulton se i përkasin periudhës së deklaruar në deklaratën “Vetting” gusht 2008 – dhjetor 2008 për të ardhurat që kanë shërbyer në krijimin e banesës ku jetoj (vlera në mbyllje / tërheqje, së bashku me interesat e depozitave në emër të bashkëshortes ka qenë respektivisht në shumën 525.400 lekë dhe 474.200 lekë; ndërsa vlera në mbyllje e depozitës në “Bankën Amerikane” (ndryshuar emri në “Intensa Sanpaolo Bank” ka qenë në vlerën 10.300 euro). Më konkretisht, depozitat bankare të sipërcituara në emër të bashkëshortes L., janë tërhequr prej saj respektivisht në datat 27.8.2008 dhe 16.9.2008, me vlerën totale të tyre rreth 1.000.000 lekë, të cilat janë konvertuar në euro me kursin e favorshëm të datave të tërheqjes (me plotësim nga të ardhurat e klinikës dhe nga paga ime) duke mundësuar krijimin, brenda datës 16.9.2008, të vlerës totale prej 10.000 eurosh.

Prandaj, kjo shumë ka qenë gjendje si likuiditet në kohën e hyrjes në bisedime me firmën “M.” dhe në datën 18.10.2008 i është dhënë administratores së saj, si “kapar”, për lidhjen në të ardhmen të kontratës së parë të porosisë.”

Subjekti ka sqaruar: “...shuma prej 19.000 eurosh iu kalua firmës “M.” në llogarinë rrjedhëse në bankën “Alpha Bank”, në datën 4.12.2008, me shënimin “Kalim... për “M.” sh.p.k., pagesë, kësti I, për blerje”... Pra palët nënshkruese të kontratës kanë konfirmuar pagesën e shumës 29.000 euro deri në datën e lidhjes së saj, duke përfshirë jo vetëm kalimin me mandat bankar të shumës prej 19.000 eurosh, por edhe vlerën e sipërcituar prej 10.000 eurosh të dhënë si “kapar” në datën 18.10.2008 (por të krijuar brenda datës 16.9.2008, nga likuiditetet prej kursimeve tona si më sipër sqaruar).”

Ndërsa, në lidhje me pagesën në shumën 20.000 euro, subjekti sqaron se data e vërtetimit, “16 tetor 2008”, e cila pasqyron shlyerjen e saj është lapsus, pasi kjo shumë sipas pretendimit të tij është paguar në ditët e fundit të dhjetorit të po këtij viti. Më konkretisht, subjekti ka cituar:

*“Konfuzioni është krijuar për shkak se këtë detyrim prej 20.000 (njëzet mijë) eurosh bashkëshortja e ka paguar/shlyer, në një nga ditët e fundit të muajit dhjetor 2008. Kjo shumë është marrë nga administratorja e firmës sipërmarrëse në mjediset e klinikës, ku ajo është gjendur për të marrë shërbimin dentar. Për këtë shkak, dokumenti shkresor për këtë pagesë nuk është nënshkruar në momentin e dorëzimit, por disa kohë më pas, prandaj data e vendosur në dokumentin që Ju citoni, përbën lapsus, të cilin nuk e kemi vlerësuar të rëndësishëm për ta korrigjuar, ndërkohë që marrëdhëniet e problematikën me firmën sipërmarrëse i kemi zgjidhur, madje prej saj është nënshkruar edhe një deklaratë noteriale, që në datën 23.09.2016.” ...si burim për krijimin e shumës prej 20.000 euro, (të përcaktuar në kontratë si detyrim për vitin 2008), ka shërbyer jo vetëm pjesa më e madhe e huas nga i vëllai, B., por edhe vlera prej 10.300 eurosh që ishte depozitë në “Bankën Amerikane”, që nga viti 2007, e cila provohet se është tërhequr në datën 11 dhjetor 2008, në të njëjtën bankë, por me emrin e ri “Intensa Sanpaolo Bank” (me të cilin njihet edhe aktualisht) ...gjatë vitit 2008 ne kemi pasur edhe detyrime të tjera financiare, përfshirë një pjesë të kredisë së marrë në bankën “Alpha Bank” në vitin 2005, për blerjen e klinikës së re në Rrugën (***) (e cila është cituar edhe nga Ju në shtjellimin e pyetjes nr. 4, si më sipër, ndonëse nuk keni kërkuar shpjegime për të), por të gjitha detyrimet për shlyerjen e kësaj kredie bankare, kanë përfunduar në datën 13.8.2008, pa prekur depozitat si më sipër cituar).*

Subjekti ka pretenduar se përmbajtja e kontratës së sipërmarrjes, e vërtetuar edhe nga noteri, së bashku me përmbajtjen e mandatpagesës së “Alpha Bank” (që ka bërë kalimin e vlerës 19.000 euro nga llogaria e kunatit në llogarinë e firmës “M.”) kanë fuqi provuese më të madhe sesa deklaratat e dorës të nënshkruara brenda apo jashtë zyrës së sipërmarrësit.

“Provueshmëria e një marrëdhënieje juridike e civile nuk mund të rezultojë nga një shkresë e thjeshtë, e titulluar “vërtetim”.

Trupi gjykues, ka vijuar në prapësimet e tij subjekti, ka zbehur tërësinë e provave dhe të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, duke i dhënë vlerë të paracaktuar një “vërtetimi”, përmbajtja e të cilit nuk kontestohet nga subjekti për sa i përket vlerës, por kundërshtohet në lidhje me datën që mbart, për të cilën ka pretenduar e pretendon se ka qenë lapsus e pa asnjë pasojë juridike mes palëve në marrëveshje.

Subjekti, për të provuar se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të shlyer këstin e vitit 2008, i referohet edhe tabelës së kontrollit të pasurisë të hartuar nga eksperti kontabël z. Q. L. .

➤ Subjekti ka depozituar:

- përmbajtjen e librezës së kursimeve nr. 24647, në emër të bashkëshortes, L. B., në lidhje me **përshkrimin e çeljes së dy depozitave** në vitin 2007;
- kontratën e depozitës në “Bankën Amerikane të Shqipërisë”, në datën 11 dhjetor 2007, në shumën 10.000 euro, me interes 3,7 %, me afat tremujor, e rinovueshme, së bashku me mandat-debinë, tërheqje e shumës 10.300 euro nga kjo bankë, e cila, në çastin e mbylljes së depozitës më 11.12.2008, kishte marrë emrin “Intensa Sanpaolo Bank”;
- deklaratën noteriale nr. (***), datë 23.9.2016 të administratorës së shoqërisë “M.” sh.p.k.;
- tabelën e kontrollit të pasurisë, të hartuar nga eksperti kontabël z. Q. L. .

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizim të fakteve dhe të provave të depozituara në dosje, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se ai është kontradiktor në shpjegimet e tij, për faktin se ndërsa pranon pagesën e këstit prej 10.000 eurosh të paguar më 18 tetor 2008, kundërshton pagesën e datës 16 tetor në shumën 20.000 euro të kryer dy ditë më parë. Pretendimi se janë paguar 10.000 euro dhe nuk janë paguar 20.000 euro, nuk mund të jetë bindës për sa kohë që subjekti pranon të ketë paguar vlerën e datës 18 tetor 2008 dhe

kundërshton pagesën e kryer në datën 16 tetor të po këtij viti, veprime këto që kanë ndodhur vetëm në harkun kohor prej dy ditësh.

Subjekti pretendon se shumë 20.000 euro e ka paguar nga fundi i dhjetorit 2008 dhe se për këtë shumë ka nënshkruar një dokument më vonë, por nuk ka depozituar dokumentin provues.

Zgjedhja e këtij argumenti nga subjekti, se nuk ka paguar shumë 20.000 euro më 16 tetor, trupi gjykues vlerëson se ajo është një përpjekje e tij për t'i qëndruar parashikimit kontraktor për pagimin e kështit prej 29.000 eurosh. Nën këtë arsyetim shpjegimet e tij nuk janë bindëse por janë kontradiktore, pasi nga njëra anë kërkon t'i qëndrohet strikt kontratës, nga ana tjetër pranon vërtetimin e datës 18 tetor, madje pranon edhe vërtetimin për pagimin e shumës 20.000 euro, duke mos e kundërshtuar atë si akt, por kundërshton vetëm datën e pasqyruar në vërtetim.

Trupi gjykues vlerëson se: i) nisur nga pretendimet kontradiktore midis konkurrimit të kontratës dhe vërtetimeve të derdhjes së shumave, ii) faktit të marrjes së huas në monedhën shqiptare dhe jo në euro, bëhet e pabesueshme provueshmëria se nuk është paguar shuma 20.000 euro para nënshkrimit të kontratës datë 13.12.2008.

Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion, pasi, edhe po të marrë të mirëqenë pretendimin e subjektit se ka paguar vetëm shumë 10.000 euro, shumë kjo e krijuar nga kursimet e vitit 2007, depozitë në “Alpha Bank” në emër të bashkëshortes, vërtetuar kjo edhe nga *statement*-i bankar, shtuar këtu edhe të ardhurat nga qiraja e përfituar nga pasuria nr. 1, me sipërfaqe 36 m², si dhe pagat e bashkëshortes së subjektit nga ushtrimi i profesionit si stomatologe në biznesin e saj privat, nga analiza financiare e kryer si në tabelën më poshtë, përsëri rezultojnë se subjekti gjendet me një balancë negative në shumë 899.670 lekë për të paguar këtë kësht dhe përballuar shpenzimet e tjera familjare deri në kohën në të cilën ka ndodhur veprimi.

	Periudha	1.1.2008 – 18.10.2008
	Pasuri	180,175
	Kësti për blerjen e vilës (10,000 euro)	1,231,825
	Ndryshim likuiditete	(1,051,650)
	Detyrime	(2,835,332)
	Kredi bankare në “Alpha Bank” për klinikën 79 m ²	(2,835,332)
(1)	Pasuri neto (Pasuri – detyrime)	3,015,507
(2)	Të ardhura	3,030,117
	Të ardhura nga paga, subjekti, deri 18.10.2008	870,939
	Të ardhura, bashkëshortja (biznesi + paga)	1,792,111
	Të ardhura nga qiratë	200,000
	Interesa bankare	167,067
(3)	Shpenzime	914,279
	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	455,400
	Shkollimi i djalit, universiteti “L.”	246,365
	Shpenzime udhëtimi, <i>TIMS</i>	40,650
	Interesa kredie në “Alpha Bank” për klinikën 79 m ²	171,864
	Analiza (2 – 3 – 1)	(899,670)

Trupi gjykues, duke marrë të mirëqenë analizën e mësipërme, sipas pretendimit të subjektit se shuma 20.000 euro përbëhet nga huaja e marrë nga i vëllai më 23 dhjetor 2008, në vlerën 2.000.000 lekë dhe nga depozita e tërhequr në “ISP Bank” në shumë 10.300 euro, konstaton se këto shuma të konvertuara në monedhën euro⁴¹ rezultojnë në shifrën rreth 26.536 euro, pra, kjo shumë rezulton të jetë më e madhe se sa kësti 20.000 euro i paguar. Kjo nënkupton se pas pagimit të shumës 20.000 euro në fund të dhjetorit 2008, sikurse është pretenduar, subjekti

⁴¹ Konvertuar me kursin mesatar EUR/ALL sipas Bankës së Shqipërisë.

duhet të kishte gjendje *cash*-i në fund të këtij viti (2008) shumën e mbetur rreth 6.536 euro. Kjo shumë nuk rezulton të jetë deklaruar⁴² në deklaratën periodike për vitin 2008, fakt që edhe në këtë rast bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit.

Nga ana tjetër, Komisioni, duke analizuar pretendimin e subjektit se ka pasur gjendje financiare edhe në fund të vitit 2007 dhe 2008, sipas tabelave të hartuara nga eksperti kontabël (*për vitin 2008 sipas tabelës 6 të përpiluar me asistencën e ekspertit kontabël Q. L. në datën 30.5.2019*), konstatoi se subjekti në fund të vitit 2008 duhet të kishte pasur gjendje *cash*-i në shumën 1.291.185 lekë në një kohë që ky pasqyrim nuk është në koherencë as edhe me shumën e mbetur nga pagesa e 20.000 eurove, siç ai pretendon. Sipas përlogaritjeve të ekspertit kontabël, nga ku rezulton se subjekti gjendet me shuma të konsiderueshme *cash*-i në fund të çdo viti, por të padeklaruara në deklaratat periodike, trupi gjykues krijon bindjen se huamarret nuk kanë pasur destinacion burimin e krijimit të pasurive.

✓ Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, pasi:

- i. bazuar në analizën financiare, ka mungesë të të ardhurave në shumën **899.670 lekë**, për të justifikuar pagesën e shumës 49 000 euro për këtë pasuri në vitin 2008, deklaruar në deklaratën “Vetting”;
- ii. nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18 tetor 2008, në shumën 10.000 euro;
- iii. nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën prej 6.536 euro sipas pretendimit të tij se ka paguar shumën 20.000 euro në fund të muajit dhjetor 2008, si dhe nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.291.185 lekë të pretenduar në tabelën e përlogaritjeve nga eksperti kontabël po për vitin 2008.

Bazuar në të gjitha provat dhe në faktet e analizuara së bashku, si dhe në shqyrtimin e rrethanave në tërësi, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimet e tij mbi nivelin e provueshmërisë së burimit të mjaftueshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, rezultuan në nivel deklarativ e, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4.33 Komisioni hetoi në lidhje me pagesën 91.000 euro, për të cilën subjekti deklaroi se është kryer përgjatë vitit 2009.

4.34 Në deklaratën për vitin 2009 subjekti ka deklaruar se ka vijuar procesi i ndërtimit të këtij apartamenti, në vlerën 160.000 euro, se ka shlyer 91.000 euro dhe se i kishin mbetur për t’u shlyer edhe 20.000 euro, të cilat duhet t’i paguante në vitin 2010 dhe se kjo pasuri nuk ishte regjistruar dhe as kishte përfunduar.

4.35 Për pagesën e kësteve në shumën 91.000 euro, subjekti ka deklaruar si burim krijimi:

- vlerën 50.000 euro kredi marrë në “Bankën Popullore”, për një periudhë 8-vjeçare me këst mujor 697.11 euro për periudhën 1.6.2009 – 1.6.2017, të cilën e ka deklaruar në deklaratën për vitin 2017 se e ka shlyer përfundimisht me shumën 4.011 euro (në këtë vit);
- borxhin e marrë në shumën 10.000 euro të vëllait, B. B., nga llogaria nr. (***) në “Alpha Bank”, shumë të cilën e deklaroi se e ka shlyer në vitin 2013 pa deklaruar burimin e krijimit;

⁴² Sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, varianti fillestar në gjuhën “d”, të nenit 4, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKP vlerën e likuiditeteve, **gjendjen *cash*** në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve në *cash*.

- borxhin e marrë të vëllait, P. B., në shumën 2.000.000 lekë, nga të cilat 1.000.000 lekë nga llogaria në “Intesa Sanpaolo Bank”, në nr. (***) llogarie dhe 1.000.000 ka deklaruar se i kishte të lira.

4.36 Nga hetimi rezultoi se sipas transaksioneve⁴³ bankare për pagesën e kësaj shume:

- në datën 13.1.2009 bashkëshortja e subjektit kishte depozituar në “Alpha Bank” shumën 16.000 euro, me përshkrim “Derdhje nga L. B., kësti i dytë për blerje apartamenti”;
- në datën 3.4.2009 kishte depozituar në “Alpha Bank” për shoqërinë ndërtimore “M.” sh.p.k., shumën 10.000 euro, me përshkrim “Derdhje nga Gurali Brahimllari, kësti i tretë, ap. nr. (***)”.

Sipas vërtetimeve:

- në datën 17.1.2009 bashkëshortja e subjektit ka depozituar për llogari të shoqërisë ndërtimore “M.” sh.p.k., shumën 5.000 euro;
- në datën 3.6.2009 ka depozituar për llogari të shoqërisë ndërtimore “M.” sh.p.k. shumën 10.500 euro;
- ndërsa, shuma 50.000 euro, marrë kredi për pagesën e këtij kësti prej 91.000 eurosh në vitin 2009, është disbursuar nga “Societe Generale Albania” në datën 1.6.2009.

4.37 Për sa sipër, Komisionit i rezultoi se shuma 91.000 euro ishte shlyer brenda datës 3.6.2009.

4.38 Gjatë hetimit administrativ, nga përgjigjet e pyetësorëve rezultoi se subjekti ka deklaruar për shlyerjen e kësaj shume një hua të marrë të vëllait, z. P. B., përkatësisht 1.000.000 lekë në muajin janar 2009 dhe 1.000.000 lekë në datën 14 gusht (me transaksion bankar nga “Intesa Sanpaolo Bank”), të po këtij viti, si dhe një hua në shumën 10.000 euro, marrë të vëllait tjetër, z. B. B.⁴⁴ në datën 17 shtator 2009. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar në pyetësorë se po në këtë vit ai ka marrë hua të tjera në vlera të vogla nga dy vëllezërit e tij, por të shlyera brenda vitit.

4.39 Nisur nga këto prova konstatohet se pagesa 91.000 euro e kësaj pasurie për vitin 2009 ka përfunduar në qershor të këtij viti, ndërsa huat janë marrë pas kësaj periudhe.

4.40 Komisioni kreu analizën financiare lidhur me aftësinë paguese të subjektit për shumën 91.000 euro, pasqyruar në tabelën e mëposhtme. Në analizë janë përfshirë të ardhurat, pasuritë, detyrimet, si dhe shpenzimet e jetesës.

	Periudha	1.1.2009 – 3.6.2009
	Pasuri	12,620,580
	Këstet për blerjen e vilës deri më 3.6.2009	12,482,470
	Ndryshim likuiditete (periudha 3.6.2009 – 1.1.2009)	138,110
	Detyrime	8,955,860
	Hua, P. 1.000.000 lekë	1,000,000
	Hua, B. (5.000 euro) ⁴⁵	685,850
	Hua, P. (3.000 euro) ⁴⁶	411,510
	Kredia (50.000 euro)	6,858,500
(1)	Pasuri neto (Pasuri - Detyrime)	3,664,720

⁴³ Referojuni akteve në aneksin 45 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴ Referojuni transaksionit bankar të “Societe Generale Albania” (dokumente që i përkasin aneksit nr. 45 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴⁵ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 5, në pyetësorin datë 26.3.2019, në dosjen e Komisionit, në të cilin subjekti është shprehur: “... pjesën tjetër prej 5.000 (pesëmijë) eurosh, sikurse kam sqaruar edhe më parë, B. e mori nga unë në fund të vitit 2009, si kthim të së njëjtës vlerë që më kishte dhënë në janar 2009.”

⁴⁶ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 5, në pyetësorin datë 26.3.2019, në dosjen e Komisionit, në të cilin subjekti është shprehur: “... Ritheksoj se unë kisha gjendje në llogarinë e “Societe Albania Bank”, në dhjetor 2009 shumën prej 7 800 eurosh, të cilën e tërhoqa duke shlyer si vëllanë, B., në vlerën e sipërcituar, edhe vëllanë tjetër, P., në shumën 3.000 euro (që ia kisha marrë në prill 2009 për pagimin e një prej kësteve të kontratës).”

(2)	Të ardhura	1,720,338
	Të ardhura nga paga, subjekti, deri më 3.6.2009	495,990
	Të ardhura, bashkëshortja	1,099,348
	Të ardhura nga qiratë	125,000
(3)	Shpenzime	227,700
	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	227,700
	Analiza (2-3-1)	(2,172,082)

4.41 Nga analiza financiare: *dukej se subjekti nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 2.172.082 lekë, për të paguar shumën 41.000 euro (pasi pjesa tjetër prej 50.000 euro përbëhej nga kredia) deri në muajin qershor 2009, si dhe për të kryer shpenzimet e jetesës; dhe se dukej se huaja e marrë në shumën 1.000.000 lekë në datën 14 gusht 2009 vëllait të tij, z. P. B., dhe 10.000 euro më 17 shtator 2009 vëllait tjetër të tij, z. B. B., nuk ka pasur destinacion shlyerjen e kështit prej 91.000 eurosh në vitin 2009 dhe, për pasojë, i kaloi atij barrën e provës për të provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, kundërshton mungesën e aftësisë paguese të tij dhe të bashkëshortes në datën 3.6.2009 për të paguar këstet e shtëpisë në vlerën totale me gjithë kredinë 91.000 euro, duke pretenduar se ka pasur të gjitha mundësitë financiare për ta kryer këtë pagesë.

Subjekti, në argumentet e tij, kërkon t'i merret në konsideratë gjendja *cash* në shumën 1.291.185 lekë që ai ka pasur një vit më parë, sipas tabelës së përlllogaritur nga eksperti kontabël.

Subjekti pretendon që përlllogaritjeve duhet t'i shtohet edhe vlera likuide (detyrime të palikuiduara nga furnitorë etj.), së bashku me vlerat monetare huashkurtër (nga z. K. B.) në vlerë totale rreth 900.000 lekë. Për këtë subjekti ka sqaruar se është normale dhe në përputhje me legjislacionin fiskal që furnitorët të likuidohen me vonesë. Gjithashtu, ai ka sqaruar se sipas dakortësisë së administratorit të biznesit me të tretët, vlera e faturave të blerjes së mallrave ose e shërbimeve mund të likuidohet me vonesë, por edhe arkëtimi mund të jetë në paradhënie.

Personi i lidhur, znj. L. B., sipas tagrave të saj si administratore e mikronjesisë dhe brenda limiteve të caktuara në ligjin për kontabilitetin, jo vetëm ka kufizuar likuidimin me vonesë nga “të tretët”, të faturave për të cilat ka kryer shërbimin dentar (*pra, ka kufizuar gjatë vitit ushtrimor kërkesat e arkëtueshme*), por edhe ka kërkuar mirëkuptimin e “të tretëve”, për shlyerjen me vonesë të detyrimeve të klinikës, pa cenuar vlerën e faturave.

Njëkohësisht, kur ka qenë rasti në pacientë të veçantë, brenda limiteve të aktivitetit të saj, dhe pa cenuar besueshmërinë e pacientëve, ka pranuar çdo kërkesë të tyre për të shlyer që në fillim vlerën e shërbimit stomatologjik që përfundonte për disa javë ose edhe dy-tre muaj, pra, ka pasur të ardhura afatshkurtër si “*parapagime të arkëtuara*”. Këtë situatë e ka lejuar si me personin e tatueshëm K. B., administrator i personit fizik me NIPT (***)⁴⁷, laborator dentar, ashtu edhe me “furnitorët” – shitësit e materialeve të konsumit afatshkurtër, por, në raste të veçanta edhe për likuidimin e faturave të sendeve me konsum afatgjatë (*pjesë e inventarit të aktiveve*).

Subjekti pretendon në disa raste edhe mangësi në likuiditete dhe pagesa të faturave të furnitorëve me vonesë, veprime këto të mbyllura brenda vitit fiskal. Për këtë arsye ai ka deklaruar se në këtë vit është vepruar edhe me “*huamarrje afatshkurtër*”, vetëm disamujore, në periudhën e vitit 2009, nga administratori i laboratorit dentar⁴⁷, z. K. B., personit fizik me NIPT (***)⁴⁷, për shkak jo vetëm të përvojës së gjatë bashkëpunuese të tij me klinikën dentare,

⁴⁷ Deklaratë noteriale nr. (***)⁴⁷, datë 7.6.2019.

por edhe si rrjedhojë e njohjes dhe e miqësisë familjare dhe e njohjes reciproke të bashkëshortëve. Subjekti ka pretenduar se për shlyerjen e këstit të kredisë në qershor 2009, krahas likuidimeve të subjektit, të bashkëshortes si pronare e drejtpërdrejtë e të ardhurave të klinikës apo të ardhurat nga qiratë e paga e djalit, janë përdorur edhe huaja afatshkurtër nga z. K. B., si dhe përdorimi i aktiveve të arkëtueshme apo i detyrimeve afatshkurtra me personat e tjerë.

Ndërsa, lidhur me huat e marra pas shlyerjes së kësteve për vitin 2009, subjekti ka deklaruar: *“...Vlera e marrë hua nga vëllai, P., shuma 1.000.000 lekë në datën 14.8.2009, pasi është plotësuar me të ardhurat familjare e personale të tij e bashkëshortes, po atë ditë është konvertuar në vlerën 10.000 euro, e cila është depozituar në bankën “Societe Generale Albania”, në të cilën shlyheshin këstet e kredisë së të njëjtës shtëpi, të së njëjtës pasuri. Prandaj në thelb edhe huaja e marrë nga P. ka pasur të njëjtin destinacion: përballimin e shpenzimeve të shtëpisë.*

Ndërsa huaja në shumën 10.000 euro, e marrë nga vëllai tjetër, B. B., në datën 17.9.2009, ka shërbyer për të balancuar detyrimet që kishim subjekti dhe bashkëshortja e tij ndaj furnitorëve të klinikës dhe, posaçërisht ndaj z. B., i cili paraqiti kërkesën e mundshme për likuidimin/kthimin e huas afatshkurtër, pasi kishte nevoja të biznesit e nevoja familjare të tij.”

Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale të z. K. B. .

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, konstaton se ky i fundit, i gjendur në pamundësi për të provuar se destinacioni i dy huave të marra në muajin gusht dhe shtator të vitit 2009 nuk ka shkuar për llogari të shlyerjes së këstit të pasurisë për vitin 2009, pasi u provua me dokumentacion⁴⁸ se ishte shlyer së bashku me kredinë deri në fillim të muajit qershor, synon të provojë se kishte pasur mundësinë për të përballuar me të ardhurat e tij shlyerjen e shumës 41.000 euro.

Lidhur me pretendimin e subjektit, se ai ka disponuar të ardhura si gjendje *cash*, sipas tabelës së përlllogaritjeve nga eksperti kontabël, trupi gjykues çmon se ndryshimi i deklarimeve të subjektit mbi pagesën e këstit për vitin 2009, është përpjekje për të krijuar një rezultat pozitiv në bilancin e tij financiar dhe se shpjegimet e tij nuk janë bindëse. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se gjendja *cash* e pretenduar nuk është deklaruar në deklaratat periodike sipas detyrimit ligjor të ligjit nr. 9049⁴⁹, datë 10.4.2003, i ndryshuar. Në kuptim të këtij ligji, trupi gjykues vlerëson se gjendjet *cash* – të pretenduara nga subjekti, si burime për krijimin e pasurive dhe për mbulimin e shpenzimeve – nuk mund të merren në konsideratë dhe, për rrjedhojë, të kenë vlerë provuese, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

Po nën këtë arsyetim, trupit gjykues i rezulton se edhe deklarata për dhënien e huas në shumën 700.000 lekë në maj të vitit 2009 nga shtetasi K. B., pasqyron dhënien e një huaje përpara qershorit 2009, çka synohet që në këtë mënyrë të provohet mundësia e aftësisë paguese të këstit për vitin 2009 deri në muajin qershor. Ndërkohë, rezulton se, megjithëse subjekti deklaroi se huaja ka qenë në shumën 900.000 lekë, në fakt huadhënësi në deklaratën noteriale deklaroi shumën 700.000 lekë. Duke mbajtur këtë linjë subjekti synon të rregullojë edhe destinacionin e huamarrjeve në gusht dhe shtator 2009 përtej pagesës së këstit 41.000 euro, në muajin qershor

⁴⁸ Referojuni mandateve (për vitin 2009) të depozituara në dosjen e ILDKPKI-së, aneksit nr.45.

⁴⁹ Varianti fillestar në germën “d”, të nenit 4, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKP vlerën e likuiditeteve, **gjendjen cash** në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve në *cash*.

të po këtij viti, duke sqaruar se huat kanë shkuar me qëllim shlyerjen e kredisë që kishte marrë në shumën 50.000 euro.

Po ashtu, edhe pretendimi i subjektit se huaja e marrë në shumën 10.000 euro të vëllait, shtetasit B. B., në muajin shtator, ka shkuar me destinacion pagimin e huas së marrë shtetasit B., nuk qëndron, për shkak se edhe nëse do të merrej i mirëqenë ky fakt, atëherë destinacioni i përdorimit të huas rezulton të jetë në favor të biznesit dhe jo të shlyerjes së këstit të kësaj pasurie.

Në përfundim, trupi gjykues çmon se deklarimi në deklaratën “Vetting” se, për krijimin e kësaj pasurie janë përdorur kryesisht të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga aktiviteti si stomatologe, pa deklaruar huamarrjet, është i pasaktë, si dhe pretendimet e tij, i vlerëson si përpjekje për të krijuar një rezultat pozitiv në analizën financiare.

Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, pasi:

- i. bazuar në analizën financiare ka mungesë të të ardhurave në shumën 2.172.082 lekë për të justifikuar pagesën e shumës 41.000 euro për këtë pasuri deri në datën 3.6.2009;
- ii. ka kryer deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të këstit prej 41.000 eurosh në vitin 2009 për këtë pasuri, pasi ka deklaruar si burim krijimi të tij dy hua të marra përtej shlyerjes, përkatësisht në shumën 1.000.000 lekë marrë shtetasit P. B., në datën 14.7.2009 dhe 10.000 euro marrë shtetasit B. B., në datën në datën 17 shtator të po këtij viti;
- iii. nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.291.185 lekë të pretenduar në tabelën e përlllogaritjeve nga eksperti kontabël të vitit 2008, mbartur për shpenzimet e gjashtëmujorit të parë për vitin 2009.

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe në shqyrtimin e rrethanave në tërësi, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimet e subjektit për nivelin e provueshmërisë së burimit të mjaftueshëm të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, rezultuan në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4.42 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e ligjshëm të huave të marra në vitin 2009.

4.43 Për vërtetësinë e fakteve dhe të rrethanave në lidhje me huan e marrë⁵⁰ në shumën 10.000 euro personit tjetër të lidhur, shtetasit B. B.:

- nga hetimi rezultoi se nga *statement*-i i llogarisë personale nr.(***), në “Alpha Bank”, huadhënësi kishte kryer një derdhje prej 10.000 eurosh (*pa përshkrim për origjinën e kësaj shume*) në datën 18.8.2009 dhe e kishte tërhequr atë më 17.9.2009 me përshkrimin “*dhënie borxh Gurali Brahimllari*”;
- lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj huaje, subjekti ka deklaruar⁵¹: “*...edhe në shtator të vitit 2009 B. më ka dhënë shumën prej 10.000 eurosh, të cilën e kam përdorur për të njëjtin qëllim, si likuiditet në shlyerjen e detyrimeve për çmimin e shtëpisë... Dokumentacioni ligjor që justifikon shumat e dhënë hua nga vëllai B. ...për vitin 2009 fitimi neto i shoqërisë “E.” sh.p.k., ka qenë në vlerën 3.489.418 lekë (të ardhura 29 105.511 lekë; shpenzime 25.616.093 lekë) deklaruar në DRT më 29.3.2010...*”

⁵⁰ Në datën 17.9.2009, sipas deklaratës noteriale nr. (***), datë 24.12.2013, në dosjen e Komisionit, si dhe deklaratës noteriale nr. (***), datë 24.12.2013, në dosjen e Komisionit.

⁵¹ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 25, në pyetësorin nr. 2, datë 24.1.2019, në dosjen e Komisionit.

- DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. (***) prot., datë 7.2.2018, ka konfirmuar fitimin *neto* të biznesit të huadhënësit, si dhe ka pasqyruar faktin se huadhënësi ka shpërndarë dividend për vitin 2009, në shumën 1.200.000 lekë.
- Pas këtij konfirmimi Komisionit i rezultoi se dividendi i shpërndarë nuk mund të justifikonte shumën e dhënë hua, e cila, e konvertuar në monedhën vendase, arrinte vlerën rreth 1.400.000 lekë. Për pasojë, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën se: *dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i huas në shumën 10.000 euro, dhënë nga i vëllai, B. B., pasi rezultoi që dividendi i shpërndarë prej tij në shumën 1.200.000 lekë, nuk ka qenë i mjaftueshëm për të mbuluar huan e dhënë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti në prapsimet e tij ka mbajtur të njëjtin qëndrim për të gjithë huatë e marra nga vëllai i tij B. duke depozituar gjithashtu të njëjtat dokumente.

Subjekti ndër të tjera ka pretenduar se burimi i ligjshëm i të ardhurave të një ortaku shoqërie të suksesshme nuk lidhet vetëm me mënyrën e disponimit të **dividendit**. Sipas pasqyrave financiare dhe të dhënave të Drejtorisë së Tatimeve Tiranë provohet bindshëm se jo vetëm në tërësi, por edhe për çdo vit ushtrimor të aktivitetit firma “E.” sh.p.k. ka qenë me fitime. Subjekti ka kërkuar marrjen si provë edhe të disa dokumenteve të tjera ligjore të të vëllait, z. B. B., që lidheshin kryesisht me pagën e tij si administrator dhe atë të bashkëshortes së tij, e punësuar në të njëjtën shoqëri, dhe për këtë ka depozituar:

- formularë për pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore me vlerën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin janar e qershor 2007, si dhe për muajt janar 2008, janar 2009, janar 2010, janar 2011 dhe janar 2012.
- certifikatën familjare të të vëllait, z. B. B., lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, e Njësisë Bashkiake nr. 2, në datën 27.5.2019.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, sikurse ka arsyetuar edhe më sipër në huamarrjen tjetër nga shtetasi B. B., nisur nga shpjegimet e subjektit se i vëllai i tij ka pasur të ardhura nga biznesi, pavarësisht se nuk është shpërndarë dividend, se ka pasur edhe kursime familjare dhe dokumentacioni i dorëzuar i provon ato, konstaton se ai nuk mundi të provojë burimin e ligjshëm të shumës së marrë hua, për arsye se dividendi i shpërndarë nuk e mbulon këtë shumë, duke e parë këtë edhe në raport me pagat e të vëllait të subjektit, të cilat, nga formularët e dorëzuar prej tij për pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për këtë periudhë, rezultojnë të jenë në nivel mesatar.

Trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të shumës 10.000 euro marrë hua nga i vëllai, shtetasi B. B., më 14 gusht 2009, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

4.44 Për vërtetësinë e fakteve dhe të rrethanave të huas tjetër të marrë⁵² në vitin 2009, në shumën 2.000.000 lekë personit tjetër të lidhur, shtetasit P. B. .

- Në lidhje me këtë fakt subjekti është pyetur⁵³ mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, për të cilën ai ka deklaruar se 1.000.000 lekë ia ka dhënë i vëllai në janar të vitit 2009 nga kursimet e tij *cash* që ka pasur në vitin 2007 – 2008, si dhe 1.000.000 lekë në gusht të po këtij viti ia ka dhënë, pasi ka transferuar nga llogaria e biznesit këtë shumë, me shënimin “*shpenzime personale*”.

⁵² Referojuni deklaratës noteriale nr. (***) , datë 25.1.2018, në dosjen e Komisionit.

⁵³ Referojuni pyetësorit datë 26.3.2019 në dosjen e Komisionit.

- Në lidhje me shumën 1.000.000 lekë të dhënë nga huadhënësi në janar të vitit 2009, rezultoi në “Raiffeisen Bank” transaksioni bankar me përshkrimin “P. B. tërheq nga llogaria, paguar pagat janar – dhjetor 2008” nga shoqëria “E.” sh.p.k., në shumën rreth 2.000.000 lekë.
- Në konkluzion, trupi gjykues nuk vëren problematikë lidhur me burimin e ligjshëm të kësaj shume të dhënë hua.

4.45 Në vijim të hetimit administrativ për burimin e ligjshëm të huas tjetër në shumën 1.000.000 lekë, të marrë nga subjekti në gusht të vitit 2009, sikurse ka deklaruar edhe vetë ai, Komisionit, nga korrespondenca e mbajtur me Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁵⁴ i rezultoi se huadhënësi ka qenë ortak i vetëm në kompaninë “E.” sh.p.k. me NIPT (***). Kjo drejtori ka konfirmuar fitimin *neto* të biznesit të huadhënësit, si dhe ka pasqyruar faktin se ai ka shpërndarë dividend për vitin 2009, në shumën 25,024 lekë, shumë e cila nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shumën e dhënë hua.

4.46 Për faktin se shuma e dhënë hua është kaluar nga llogaria e kompanisë, në llogarinë personale të huadhënësit me përshkrimin “Për shpenzime personale”, Komisioni i ka kërkuar DRT-së Tiranë dhe kompanisë “E.” sh.p.k., pasqyrat financiare për vitet 2009, për të verifikuar se si pasqyrohet llogaria e ortakut.

4.47 Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga DRT-ja Tiranë⁵⁵, rezultoi se në pasqyrat financiare për vitin 2009 llogaria e ortakut rezulton pa detyrime.

4.48 Njëkohësisht, edhe kompania “E.” sh.p.k.⁵⁶ ka depozituar bilancet e shoqërisë, në të cilën pasqyrohet se llogaria e ortakut rezulton pa detyrime, si dhe informon se nuk rezulton që ortakut dhe administratori i vetëm të ketë bërë transaksione me shoqërinë, prandaj edhe në bilancet e shoqërisë nuk ka llogari të tillë.

4.49 Për sa më sipër, Komisionit nga analizimi i dokumentacionit të depozituar si nga subjekti, por edhe nga korrespondenca e mbajtur gjatë hetimit administrativ me institucionet dhe kompaninë “E.” sh.p.k., i rezultoi se: *dukej se nuk provohej burimi i ligjshëm i huas së dhënë subjektit në shumën 1.000.000 lekë në muajin gusht të vitit 2009, shumë e transferuar nga llogaria e biznesit të huadhënësit në llogarinë e tij personale dhe për pasojë i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti ndër të tjera ka deklaruar se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, edhe për vëllanë, P., ka qenë i plotë, ndonëse për shkaqe personale veprimtaria e tij tregtare si administrator i shoqërisë “E.” sh.p.k. pati problematikë negative në maj të vitit 2010, e cila solli në vijim kalimin në pasiv të shoqërisë.

Subjekti i rivlerësimit pretendon se në janar 2009 (*pas mbylljes së vitit ushtrimor 2008*), personi tjetër i lidhur, P. B., ka pasur likuiditet të lirë për t’i dhënë hua si vlerën e deklaruar për muajin janar 2009, ashtu edhe gjatë periudhave të mëpasshme të të njëjtit vit.

Subjekti ka depozituar dhe kërkuar të merren në konsideratë provat e paraqitura në vijim:

- vendimin nr. 4, datë 20.6.2009, të ortakut të vetëm të shoqërisë “E.” sh.p.k., P. B.;
- vërtetimin e shoqërisë “E.”, datë 19.5.2019, për pagën bruto dhe neto në vlerën 80.000 lekë/muaj, të ish-administratorit të kësaj shoqërie, z. P. B., për periudhën dhjetor 2006 – dhjetor 2013;

⁵⁴ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 7.2.2018, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 18.4.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Shkresa datë 27.4.2019 dhe dokumentacioni bashkëngjitur i shoqërisë “E.” sh.p.k. , në dosjen e Komisionit.

- praktikën e shoqërisë në lidhje me pagat e deklaruara më 14.10.2008, formularin e deklaramit për në sigurimin shëndetësor e shoqëror dhe mandatpagesën e vlerës 59.698 lekë, si dhe formularin e deklaramit mbi të ardhurat nga punësimi të të njëjtit muaj dhe mandatpagesën në bankë me vlerën 12.700 lekë;
- listpagesën e punonjësve të kësaj shoqërie për muajin shtator 2008;
- certifikatën familjare me nr. (***) të z. P. B., lëshuar më 27.5.2019 nga ZGJC-ja e Njësisë Bashkiake Nr. 4.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe aktet e depozituara prej tij, konstaton se dokumentacioni nuk ka nivelin e provueshmërisë për burimin e krijimit të kësaj huadhënieje. Vendimi i shoqërisë "E." i depozituar nga subjekti rezulton se nuk i përket periudhës në të cilën i është dhënë huaja dhe, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë. Vërtetimet e pagave të huadhënësit dhe të bashkëshortes së tij, nëpërmjet të cilëve pretendohet të provohet se huaja e dhënë ka si burim edhe kursimet e tyre, nuk mund të merren në konsideratë nga Komisioni, sepse zanafilla e këtij transaksioni bankar është nga kompania dhe jo nga kursimet personale apo edhe ato familjare.

Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës 1.000.000 lekë të dhënë hua nga vëllai i tij me cilësinë e personit tjetër të lidhur, se ka si burim krijimi kursimet e këtij të fundit nga paga dhe fitimi i kompanisë, në të cilën rezultoi të jetë ortak dhe administrator i shoqërisë, nuk qëndron. Kjo, për faktin se transaksioni bankar është kryer nga llogaria e kompanisë në llogarinë personale të huadhënësit. Komisionit i rezultoi se huadhënësi kishte shpërndarë dividend për vitin 2009, por shuma e shpërndarë në raport me atë të dhënë hua pasqyrojnë një diferencë relativisht të lartë. Për këtë arsye duhet të ishte paguar tatim mbi diferencën e shumës së dhënë hua me atë të shpërndarë dividend.

Meqenëse shuma e kaluar nga kompania nuk rezultoi të ishte pasqyruar në bilancet e shoqërisë si një huamarrje e ortakut ndaj saj, për pasojë nuk mund të provohet burimi i ligjshëm i krijimit të saj.

Pavarësisht se: i) biznesi rezulton me fitim, ii) nuk provohet tatimi i paguar i këtyre të ardhurave, iii) është shpërndarë dividend në shumën 25.024 lekë, në raport me huadhënien kjo shumë është shumë herë më e ulët.

Për shkaqet e arsyetuara më sipër, Komisioni vlerëson se dokumentacioni i depozituar nga subjekti nuk përbën provë për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua, pasi kursimet nga pagat e huadhënësit dhe bashkëshortes së tij nuk kanë qenë burim i saj.

Për sa sipër, trupi gjykues arrin në konkluzion se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të shumës 1.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi P. B., në gusht të vitit 2009, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

4.50 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të pagesës 20.000 euro për këtë pasuri në vitin 2010.

→ Kredi në shumën 25.000 euro.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

4.51 Në deklaratën për vitin 2009 subjekti kishte deklaruar se pasi kishte shlyer vlerën 91.000 euro për këtë pasuri i kishte mbetur pa paguar edhe shuma 20.000 euro, e cila do të shlyhej në vitin 2010.

4.52 Në deklaratën për vitin 2010 subjekti kishte deklaruar se kishte shlyer këstin e fundit të kësaj pasurie në vlerën 20.000 euro, pa deklaruar burimin e krijimit të kësaj shume.

4.53 Në deklaratën “Vetting” subjekti kishte deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie kredinë në shumën 25.000 euro marrë në “Bankën Popullore”.

4.54 Po në këtë deklaratë, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, kishte deklaruar se kjo kredi ka shlyer huan e marrë nga i vëllai në vitin 2010.

4.55 Në deklaratën për vitin 2010 nuk kishte deklaruar destinacionin e kësaj kredie.

4.56 Komisioni e pyetur subjektin dhe, ndër të tjera, ai ka deklaruar se *kishte marrë këtë kredi me qëllim shlyerjen e huas së marrë personit tjetër të lidhur, vëllait të tij, z. B. B., në janar 2010 në shumën 25.000 euro.*

4.57 Në deklaratën për vitin 2010 subjekti nuk kishte deklaruar marrjen e kësaj huaje.

4.58 Komisioni e ka pyetur⁵⁷ subjektin në lidhje me këtë hua, për të cilën ai ka deklaruar: “*B. ka kontribuar me 15.000 euro dhe P. me 5.000 euro... (20.000 euro, shumë e shlyer në janar 2010 për këtë pasuri si këst i fundit i saj), se shumën e fundit (5.000 euro) sërish e ka mbajtur si obligim vëllai, B., për faktin se huadhënësi, P., ka pasur probleme me aktivitetin e tij në vitin 2010 dhe, për pasojë, detyrimi ndaj vëllait, B., ka qenë në shumën 20.000 euro, duke i shtuar kësaj shume edhe 5.000 euro, të cilat po vëllai, B., m’i ka dhënë herë pas here për shlyerjen e kësteve të kredisë në vitin 2010 (Kredi e përfituar në vitin 2009 për këtë pasuri në shumën 50.000 euro.) B. ka sqaruar se këtë vlerë e ka krijuar nga burimi i ligjshëm nga puna në aktivitetin e tij dhe për këtë keni vënë në dispozicion disa dokumente.”*

✓ Nga hetimi i kryer nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisionit i ka rezultuar se kredia është disbursuar në dhjetor të vitit 2010, me qëllim blerje shtëpie dhe se ajo është kaluar me transaksion bankar për llogari të vëllezërve të subjektit, B. dhe P. B., me përshkrim “shlyerje borxhi”.

✓ Nga hetimi i kryer në lidhje me burimin e krijimit të këtyre huadhënieve Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika.

4.59 Në lidhje me shlyerjen e shumave të marra hua, si dhe me aftësinë paguese të kësaj pasurie prej vitit 2008 – 2016

4.60 Komisioni hetoi mbi mundësinë financiare të subjektit për të shlyer huat e marra për blerjen e kësaj pasurie.

4.61 Nga hetimi rezultoi se subjekti kishte marrë hua gjatë viteve 2008 – 2010 dhe i kishte shlyer ato përgjatë viteve 2009 – 2013, pa deklaruar burimin e krijimit.

4.62 Gjithashtu, Komisioni kreu edhe analizën financiare për vitet 2008 – 2016 për të parë aftësinë paguese të subjektit mbi këtë pasuri.

4.63 Informacioni i mësipërm është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelat e mëposhtme për secilin zë:

Huat e marra nga shtetasi B. B.

Muaji/Viti	Shuma e marrë hua	Shuma e shlyer	Dokumentacioni
23/12/2008	2,000,000		Deklaratë noteriale nr. (***) , datë 21.12.2009

⁵⁷ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 5 në pyetësorin datë 26.3.2019, në dosjen e Komisionit.

janar 2009	685,850		Pyetësori 26.3.2019
17.9.2009	1,371,700		
dhjetor 2009		685,850	Pyetësori 26.3.2019
janar 2010	694,050		Pyetësori 26.3.2019
janar 2010	2,082,150		Pyetësori 26.3.2019
gjatë vitit 2010, paguar këstet e kredisë prej 50.000 eurosh	694,050		Pyetësori 26.3.2019
16.12.2010		3,470,250	Kredia në “SGA Bank”
30.12.2011		1,000,000	Deklaratë noteriale nr. (***) , datë 30.12.2011
19.12.2013		1,402,100	
24.12.2013		1,000,000	Deklaratë noteriale nr. (***) , datë 24.12.2013
Total	7,527,800	7,558,200⁵⁸	

Huat e marra nga shtetasi P. B.

Viti	Shuma e marrë hua	Shuma e shlyer	Dokumentacioni
janar 2009	1,000,000		
14.8.2009	1,000,000		
prill 2009	411,510		Pyetësori 26.3.2019
dhjetor 2009		411,510	Pyetësori 26.3.2019
janar 2010	694,050	694,050	Pyetësori 26.3.2019
2010		2,000,000	Deklaratë noteriale nr. (***) , datë 25.1.2018
Total	3,105,560	3,105,560	

Huat nga shtetasi A. S.

Muaj/Viti	Shuma e marrë hua	Shuma e shlyer	Dokumentacion
19.9.2002	1,500,000		“Kontratë huaje” nr. (***) , e lidhur në datën 19.9.2002
4.12.2008	2,340,468		Transaksion bankar nga “Alpha Bank”
14.8.2012		4.000.000	Kontratë shitjeje nr. (***) , datë 14.8.2012

Hua nga K. B.

Muaj/Viti	Shuma e marrë hua	Shuma e shlyer	Dokumentacion
maj 2009	700,000		Deklaratë noteriale nr. (***) , datë 7.6.2019
2009		700,000	

Rezultati financiar për pasurinë nr. 4

Viti	Balanca
2008	132,140
2009	84,760
2010	-1,272,349

⁵⁸ Diferenca prej 30.400 lekësh vjen si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit nga momenti i dhënies së huas në vitin 2009 dhe kohës së shlyerjes në vitin 2013. Duke qenë se analiza është kryer në monedhën vendase, lekë, si rezultat i kursit të këmbimit pasqyrohet kjo diferencë, por dhënia dhe shlyerja është kryer në valutë, kështu që nuk ka diferenca reale në shlyerje.

2011	-1,627,097
2012	-2,137,681
2013	2,283,054
2014	2,712,616
2015	-452,320
2016	727,603

4.64 Si rezultat i analizës financiare të kryer nga Komisioni, në lidhje me shlyerjet e huave dhe me aftësinë paguese të kësaj pasurie i rezultoi se: *dukej se për vitin 2010, subjekti nuk kishte pasur burime të ligjshme në shumën 1.272.349 për shlyerjen e shumës së marrë hua vëllait të tij, P. B., në vitin 2009; dukej se subjekti nuk kishte pasur burime të ligjshme për shlyerjen e shumës 1.000.000 lekë ia marrë hua në vitin 2011 vëllait të tij, shtetasit B. B.; dukej se në tërësi, subjekti nuk kishte pasur burime të mjaftueshme në shumën 5.489.447 lekë, për blerjen e kësaj pasurie, për shlyerjen e huave, kësteve të kredive, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të familjes suaj, përgjatë viteve 2008 – 2016; dukej se kishte mungesë të dokumentacionit justifikues (pasqyra e bilancit e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra, e detajuar për secilin aset, në secilin vit) që të provonte krijimin e shumave të amortizimit për periudhën 2008 – 2016 dhe, për pasojë, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, vijon të pretendojë se ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të shlyer huat, si dhe për të investuar në këtë pasuri. Subjekti pretendon se ka pasur të ardhura nga kursimet e tij familjare, nga aktiviteti i bashkëshortes, nga pagat e tij, si dhe nga paga e të birit. Subjekti pretendon se ka pasur gjendje *cash* në fund të çdo viti sipas përlllogaritjeve të pasqyruara në tabelën e ekspertit kontabël dhe që sipas tij duhen marrë në konsideratë. Subjekti ka depozituar edhe pasqyrat e aktiveve afatgjatë për të konfirmuar vlerat e amortizimit të pretenduara si të ardhura.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk qëndrojnë dhe as provojnë të kundërtën e konstatimeve të tij, për faktin se: i) ai nuk ka deklaruar përgjatë deklarimeve periodike të këtyre viteve asnjë herë gjendje *cash* dhe, për pasojë, ajo as nuk mund të ketë ekzistuar dhe as nuk mund të merret në konsideratë në përlllogaritje; ii) pretendimi i gjendjes *cash* bën të pabesueshëm deklarin se për këtë pasuri janë marrë hua në mënyrë të vazhdueshme dhe në shuma të konsiderueshme.

Pretendimi i subjektit se duhet të mbartet për vitin pasardhës gjendja *cash* dhe balancat pozitive të pasqyruara në Tabelën e Kontrollit të Pasurisë, të dorëzuar prej tij, nuk mund të pranohet, pasi subjekti ka pasur detyrimin e deklaramit të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore.

Në të njëjtën kohë pasqyra e dorëzuar bie në kontradiktë me *cash*-in e deklaruar nga subjekti. Subjekti në gjithë deklarinimet e tij nga viti 2003 – 2016 ka deklaruar gjendje *cash*-i vetëm për vitin 2014 në shumën 800.000 lekë dhe për vitin 2016 në shumën 400.000 lekë, çka nënkupton se subjekti ka pasur dijeni mbi mënyrën se si duhej plotësuar deklaratat periodike.

Ndërkohë në tabelën e dorëzuar nga subjekti, të përgatitur nga eksperti rezulton se gjendja e *cash-it* për vitin 2014 që pretendohet për t'u mbartur është në shumën 2.134.219 lekë dhe për vitin 2016 në shumën 2.437.682 lekë.

Nëse Komisioni do të merrte të mirëqenë këtë pretendim, pra, sikur subjekti t'i kishte pasur realisht ato, atëherë rezulton se ai ka kryer fshehje të pasurisë, për shkak se në asnjë nga deklaratat vjetore periodike nuk rezulton të jetë bërë deklarimi i tyre.

Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e të gjithë shumës së amortizimit si e ardhur, Komisioni kreu hetimin e pasqyrave të dorëzuara, nga ku rezultoi se përlllogaritja e kryer nga hartuesja e pasqyrave financiare të bashkëshortes së tij nuk ishte e saktë. Në këto pasqyra për vitet 2009 – 2011 ishte përfshirë e gjithë vlera e amortizimit për ndërtesën (klinikën). Komisioni nuk vlerëson të marrë në konsideratë të gjithë vlerën e amortizimit të klinikës sipas hartueses, për shkak se bashkëshortja e subjektit e ka amortizuar klinikën në të gjithë vlerën e saj. Kjo ka sjellë shtim të shpenzimeve në një shumë që nuk i takon dhe, për pasojë, fitim në një vlerë më të ulët, si dhe pagesë për tatim-fitimin më pak. Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm ½ e vlerës së amortizimit të ndërtesës/klinikës, për arsye se bashkëshortja e subjektit është pronare vetëm 50 % e klinikës dhe, si rrjedhim, duhet të amortizojë vetëm pjesën e saj takuese, pra, ½ e vlerës.

- ✓ Për sa më sipër, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se ato nuk janë bindëse, ngaqë në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, pasi:
 - bazuar në analizën financiare, ka mungesë të të ardhurave në shumën **6.840.639** lekë për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, për shlyerjen e huave të marra, e kësteve të kredive në shumën 25.000 euro dhe 50.000 euro, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të familjes së tij, përgjatë viteve 2008 – 2016.

Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe në shqyrtimin e rrethanave në tërësi, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Nr	Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	TË ARDHURA	1,540,177	2,544,445	3,229,841	4,954,357	5,778,158	3,331,849	3,809,147	3,603,092	4,149,663	9,030,023	5,828,553	8,001,252	8,426,918	6,298,561
	Paga SR	600,047	1,095,000	1,119,483	1,087,691	1,120,945	1,102,249	1,133,457	1,401,025	1,266,120	1,371,673	1,262,693	1,629,888	1,855,115	1,685,753
	Të ardhura Bashkëshortja	840,000	1,225,000	2,100,000	3,466,666	4,350,000	1,862,533	2,348,435	1,854,255	1,951,538	2,260,066	2,773,965	4,286,713	4,714,717	2,993,722
	Paga Djali	-	-	-	-	-	-	-	43,560	632,005	638,284	659,895	823,078	817,086	866,230
	Të ardhura nga shpërbilimet + paga e vajzës në klinikën e famijes	-	-	-	-	27,000	-	27,000	-	-	-	-	121,573	-	-
	Të ardhura nga interesat bankare	100,130	224,445	10,358	-	40,213	167,067	255	4,252	-	-	-	-	-	32,856
	Të ardhura nga shitja e makinës tip Benz *** DT.05/09/2006	-	-	-	400,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Të ardhura nga qiratë	-	-	-	-	240,000	200,000	300,000	300,000	300,000	760,000	1,132,000	1,140,000	1,040,000	720,000
	Të ardhura nga shitja e klinikës së Kuçovës (kunatit)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,000,000	-	-	-	-
2	SHPENZIME	375,856	429,087	4,781,876	1,713,213	3,601,054	496,253	8,561,305	1,003,094	3,703,784	7,667,269	5,743,908	3,426,880	5,159,331	3,439,197
	Shpenzime jetike sipas LDKPKI	375,856	375,856	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368
	Tatim perqirate	-	-	-	-	-	-	-	30,000	-	76,000	113,200	114,000	156,000	108,000
	Shkollimi i djalit, Universiteti L.	-	-	-	247,406	483,540	246,365	548,680	555,240	-	-	-	-	-	-
	Shkollim Master në Univ. Tiranës	-	-	-	-	-	-	-	50,000	50,000	-	-	-	-	-
	Pagese 1% e rivlersimit te pasurive	-	-	-	-	-	-	-	-	125,000	131,796	-	-	-	-
	Kredi (principal +interesi) djali në ProCredit Bank dt.03/02/2012 (420.000 ALL)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	255,092	197,039	203,227	-	-
	Shkollimi i djalit, Master (150.000 ALL)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	150,000	-	-	-	-
	Shpenzime arrendimi vila në Sauk	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,250,000	250,000	-	-	500,000
	Tarifa e shkollimit për vajzën (stomatologji)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	31,900	36,000	36,000	36,000
	Vajza shpenzime karta kreditit (Credins)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	17,199	4,826	67,600	55,468
	Gruaja tatim fitim per biznesin	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8,242
	Shpenzime pushimesh	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	208,072	224,176	344,125	324,648
	Shpenzime TIMS	-	53,231	267,137	16,081	81,010	40,650	-	137,422	342,984	251,496	171,056	334,863	225,746	389,578
	Kredi (principal+interesi) në Alpha Bank për Klinikën 74.3 m2 (12/05/2005) (50.000 EUR)	-	-	5,531,233	1,004,817	2,483,395	3,007,195	-	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime bankare për kredinë në Alpha Banka (50.000 euro)	-	-	43,992	6,680	6,529	3,523	-	-	-	-	-	-	-	-
	Kredi (principal +interesi) në Bankën Popullore DT.01/06/2009 (50.000 Eur)	-	-	-	-	-	-	6,284,765	1,154,202	1,156,924	1,170,798	1,153,468	1,144,365	930,790	1,085,136
	Kredi (principal+interesi) në Bankën Popullore (SGA) DT.16/12/2010 (25.000 Eur)	-	-	-	-	-	-	-	3,470,250	482,396	484,080	485,777	485,431	2,493,733	-
	Hua	-	-	-	-	-	4,340,468	3,371,700	2,000,000	1,000,000	4,000,000	2,402,100	-	-	-
3	PASURI	387,532	2,004,064	7,340,815	2,696,612	2,059,913	3,695,962	12,575,692	4,162,347	2,362,976	3,500,434	2,198,409	5,592,644	10,980	2,131,760
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme														
	Klinikë dentare 50 m2, Kuçovë +trualli 38.25 m2 (14/08/2012)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	64,064	-	-	-	-
	Apartament, Rr. *** (20+1.6)36 m2, Tiranë (përshatur për Klinikë)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Apartament 2+1 Rr.***, 116 m2, Tiranë (3.000.000 +1.000.000 leke)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Autoveturë Tip Benz,***, viti prodhimit 1987 (shitur në 2006)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Klinikë dentare, Rr.***74.3 m2, Tiranë (2004)93.000 Eur	-	5,449,820	6,739,700	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Blerje aparature (për klinikën dentare 31/03/2005)15.100 Eur	-	-	1,899,731	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Blerje aparature (për klinikën dentare 25/02/2007)	-	-	-	-	1,827,453	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Autoveturë Tip Benz, *** DT.29/08/2006	-	-	-	800,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Vilë në Sauk kontrata DT.13/12/2008 (160.000 Eur) +2.000.000 punime shtese	-	-	-	-	-	6,035,943	12,482,470	2,776,200	850,000	1,150,000	-	-	-	-
	Blerje aparature (për klinikën dentare 14/11/2014) (3.200 Eur x 139.61)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	446,752	-	-
	Autoveturë Audi A5 14/08/2014**** (21.000 Eur) nga biznesi stomatologji	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2,917,740	-	-
	ndryshim Likuiditeti (gjenja në fund të vitit - gjenja në fillim të vitit)	387,532	-3,445,756	-1,298,616	1,896,612	232,460	-2,339,981	93,222	1,386,147	1,512,976	2,286,370	-2,198,409	2,228,152	-10,980	2,131,760
	BALANCA (1-2-3)	776,789	111,294	670,902	544,533	117,192	132,140	-205,240	-1,362,349	-1,917,097	-2,137,681	2,283,054	-1,018,272	3,278,568	727,603

5. Deklarimi i pasurive të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij

Asete të personit fizik L. B.:

- a. llogari rrjedhëse në “BKT” me vlerë 8.018 euro;
 - b. llogari rrjedhëse në “BKT” me vlerë 746.166 lekë;
 - c. automjet “Audi”, me targë (***) , blerë në vitin 2014, me çmimin 2.917.740 lekë;
 - d. aparaturë dentare “Kavo” me vlerë 1.918.957 lekë;
 - e. aparaturë dentare “Kavo” me vlerë 1.827.453 lekë;
 - f. autoklavë me vlerë 446.751 lekë.
- ✓ Komisionit, në tërësi nga hetimi administrativ për këto pasuri të deklaruara nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nuk i kanë rezultuar dyshime mbi krijimin e tyre.

6. Gjetje të tjera

➔ Lidhur me gjendjen në arkë të biznesit të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortes së tij.

6.1 Gjatë hetimit administrativ të bilanceve të aktivitetit, klinikë dentare, të bashkëshortes së subjektit, për vitet 2010 – 2013 dhe 2015 – 2016, Komisionit i rezultuan gjendje të konsiderueshme *cash*⁵⁹ në arkën e shoqërisë, të cilat nuk ishin deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike të këtyre viteve, por as edhe në deklaratën “Vetting” dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, ka pretenduar: “... gjetja e kësaj “gjendje arka” duket se ka krijuar te Komisioni përshtypjen e gabuar, se në mjediset e klinikës dentare, çdo fundvit (çdo 31 dhjetor të periudhës 2010 – 2015) paska pasur “gjendje cash”, në vlera monetare të konsiderueshme dhe, madje, të padeklaruara.” dhe se atij kurrë më parë nuk i është kërkuar të japë shpjegime gjatë hetimit administrativ për këtë problematikë.

Subjekti e konsideron vendosjen e gjendjes “arka”, në fund të çdo viti ushtrimor, në vlera monetare të pazakonta, si *lapsus*/gabim material të paqëllimtë e pa pasoja financiare, jo vetëm për subjektin tatimpagues, por edhe për analizën e vlerësimit të kriterit pasuror të viteve 2010 – 2015.

Bëhet fjalë vetëm për një *lapsus*/gabim material e përpilueses të pasqyrave financiare dhe/ose paaftësi e saj për të interpretuar siç duhet ligjin dhe udhëzimet “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Për shkak të mosnjohjes mirë të profesionit apo për neglizhencë, mbajtësja e pasqyrave financiare (apo e bilancit tregtar të “personit fizik”), znj. F. K., në periudhën e viteve 2010 – 2015, rezulton se nuk ka përcaktuar në bilancet e dorëzuara në organin tatimor “vlerën monetare për shpenzime familjare e personale”, por të gjitha shpenzimet e përballuara nga të ardhurat e ligjshme të klinikës dentare, edhe për qëllime jashtë nevojave të funksionit të shërbimit stomatologjik, i ka përlllogaritur si vlerë monetare, gjendje në zërin “arka”.

Ky fakt është konsideruar nga Komisioni si “gjetje” e mjaftueshme për të ngritur dyshime se në mjediset e subjektit tatimpagues ka pasur vlera monetare të përcaktuara si gjendje “arka”, në sasi të konsiderueshme, ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar ato si gjendje *cash*, as në vite, dhe as në deklaratën “Vetting”.

Subjekti ka theksuar se pasaktësitë e përpilueses së pasqyrave financiare për regjistrimet e veprimeve kontabël në to, ndonëse nuk janë konstatuar nga administrata tatimore gjatë

⁵⁹ Referojuni tabelës nr. 9 në Rezultatet e hetimit administrativ.

kontrolleve të ushtruara në vite në klinikë, rezultojnë të provuara se janë korrigjuar prej saj për periudhën vijuese të viteve 2016, 2017 dhe 2018.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me problematikën “gjendja arkë” në pasqyrat financiare të mikronjesisë së administruar nga personi i lidhur (bashkëshortja), me provat e paraqitura në Komision, të cilat u pranuan me vendim të ndërmjetëm të datës 30.5.2019, dhe janë pjesë e procesit të rivlerësimit, ka cituar se:

“- duke përdorur kasën fiskale në mjedisin e mikronjesisë, lëshimi i kuponit tatimor është dokumenti ligjor i mjaftueshëm për dokumentimin e transaksioneve për pagesat me para në dorë dhe se nuk është i detyruar të lëshojë mandatarkëtimin, duke zbehur kuptimin e gjendjes arkë;

- mungon qëllimi i subjektit tatimor, personit të lidhur, L. B. që, nëpërmjet parregullsisë në pasqyrat financiare të bilancit të personit fizik, të shmangë detyrimet fiskale, dhe posaçërisht, vlerën e tatim-fitimit të thjeshtëzuar;

- mungon realisht gjendje fizike cash në arkën e shoqërisë në fund të viteve respektive.”

Subjekti pretendon se ky qëndrim është në harmoni edhe me përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr. (***) prot., datë 29.5.2019: “ ... pas përmbushjes në mënyrë korrekte të detyrimeve ligjore, destinimi dhe përdorimi i mjeteve monetare (të fitimit të vitit) nga personi fizik për nevoja biznesore apo personale/familjare të tij, nuk përbën moment për detyrime tatimore shtesë për këto të ardhura dhe përdorimi i tyre është në të drejtë të plotë të tatimpaguesit...Gjithashtu, mënyra e pasqyrimit dhe regjistrimit të aktiveve të mjeteve monetare në pasqyrat financiare, për të cilat është paguar tatim mbi të ardhurat, nuk përbën moment për detyrime tatimore shtesë... kuponi tatimor është dokument ligjor, i mjaftueshëm, për dokumentimin e transaksioneve për pagesat me para në dorë (cash) dhe shërben në të njëjtën kohë si dokument justifikues për lëvizjet në shtim, të mjetit (monetary arka). Tatimpaguesi, për qëllim të këtij transaksioni, nuk është i detyruar të lëshojë mandate arkëtimi (i cili nuk është dokument tatimor i njohur)”. Sikurse del nga ky interpretim, (por edhe nga analiza tërësore e provave shkresore, që u pranuan nga Komisioni me vendimin e ndërmjetëm të datës 30.5.2019), efekti i mënyrës së përpilimit të pasqyrës financiare, edhe pse jo korrekte me legjislacionin që normon “Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, është vetëm balancimi formal i aktiveve dhe pasiveve të mikronjesisë që funksionon si person fizik me përgjegjësinë tatimore të biznesit të vogël. Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur kurrë detyrimin të deklarojë si gjendje cash vlerën e pasqyruar si “gjendja arkë” në bilancin e klinikës dentare, për faktin e thjeshtë se kjo “gjendje” as nuk ka ekzistuar dhe as nuk mund të ekzistonte, për më tepër, në vlera të konsiderueshme, sikurse shprehet Komisioni. Subjekti kundërshton interpretimin në rezultatin e hetimit administrativ të datës 15.5.2019, sikur kjo gjendje ka qenë vlerë monetare cash e mbajtur në mjediset e klinikës dhe se nga ajo nuk është deklaruar në ILDKPKI as në vite, dhe as në deklaratën “Vetting”.

Subjekti ka depozituar:

- kërkesën për interpretim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme Tatimore, datë 23.5.2019, dhe përgjigjen e këtij institucioni me shkresë nr.(***)prot., datë 29.5.2019;
- opinionin financiar në lidhje me pasqyrat financiare nga z. S. L., datë 23.5.2019;
- sqarim për gjendjen e arkës nga znj. F. K., hartuesja e pasqyrave financiare të aktivitetit të bashkëshortes;
- vlerësimin e pasurisë nga eksperti kontabël, z. Q. L., ku janë pasqyruar analizat për secilën pasuri përpara vitit 2003, si dhe tabela përmbledhëse për periudhën 2003 – 2016.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni thelloi hetimin për këtë konstatim, për vetë faktin se burimi i deklaruar i krijimit të pasurive në deklaratën “Vetting”, kryesisht kanë qenë të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortes së subjektit, dhe për pasojë, çdo dyshim i provuar ose jo do të ndikonte përllogaritjet financiare në balancë pozitive apo negative.

Komisioni i administroi provat e depozituara nga subjekti dhe kreu vlerësimin e tyre nga ku ka konstatuar se:

-Në opinionin e dhënë nga shtetasi S. L. dhe në kërkesën e subjektit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*kërkesë për interpretim*), vihet re se në të dyja rastet sqarohet lidhur me faktin nëse pronari i mikronjesisë mund të përdorë dhe të tërheqë në mënyrë të lirshme fondet e mikronjesisë për nevojat e veta dhe të familjarëve, por nuk shpjegohet lidhur me “gjendjen në arkë”.

Në lidhje me pretendimin se: *“efekti i mënyrës së përpilimit të pasqyrës financiare, edhe pse jo korrekte me legjislacionin që normon ‘Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare’, është vetëm balancimi formal i aktiveve e pasiveve të mikronjesisë që funksionon si person fizik me përgjegjësinë tatimore të biznesit të vogël”*, Komisioni argumenton se, sipas Standardeve Kombëtare të Kontabiliteti, më konkretisht SKK nr. 15, aneksi 1 i këtij standardi, pasqyron formatet e detyrueshme të bilancit kontabël, ku në tabelë kërkohet pasqyrimi i mjeteve monetare. Pra, mjetet monetare, ndryshe nga sa pretendon subjekti, kanë qenë një detyrim dhe jo një balancim formal i aktiveve dhe pasive.

Subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit që nuk ka deklaruar gjendjen e vlerës monetare *cash* të mbajtur në mjediset e klinikës. Ky pretendim nuk qëndron, për arsyen se, sipas ILDKPKI-së, personat e lidhur me subjektin që ushtrjnë aktivitet biznesi në formën e personit fizik, kanë detyrimin për të deklaruar të gjitha të drejtat dhe detyrimet, aktivet, pasivet dhe mjetet monetare të biznesit, sepse përgjegjësia është e pakushtëzuar.

Komisioni, në analizën financiare të kryer nga viti 2010 e në vijim, ka përfshirë gjendjen faktike të arkës, sipas bilancit të dorëzuar nga bashkëshortja e subjektit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit se ai ka tërhequr shumën të caktuar për nevoja personale dhe familjare, Komisioni vlerëson se kjo është një e drejtë e çdo biznesi në formën e personit fizik dhe si rrjedhim nuk sjell ndryshime apo pasoja në gjendjen e arkës të konstatuar në bilancin e dorëzuar nga bashkëshortja e subjektit.

Po ashtu, Komisioni vëren se deklarimi i subjektit lidhur me pretendimin se ai ka përdorur kasën fiskale, nuk e zbeh konceptin e arkës, përkundrazi, e thekson edhe më tepër ekzistencën e saj.

Në prapësimet e tij, subjekti thekson vazhdimisht se është ngatërruar termi “arkë” me vlerën e tërhequr nga pronari për llogari personale, duke e pretenduar atë si “lapsus” të hartueses së pasqyrave financiare.

Mbi këtë pretendim të subjektit, Komisioni konstaton se edhe nëse do të merrej i mirëqenë *“lapsusi apo gabimi”*, se vlera e pasqyruar në zërin “arka” është “vlera që ka tërhequr pronari”, siç e pretendon aktualisht subjekti, rezultojnë:

- mospërputhje të mëdha lidhur me shumën e tërhequra në raport me fitimin e vitit fiskal apo me përdorimin e tyre, siç e ka deklaruar edhe vetë subjekti, që fitimi i aktivitetit *“klinikë dentare”* është përdorur për shlyerjen e borxheve të marra, këstet e kredisë, si edhe këstet e vilës.

- Më konkretisht, në tabelën e mëposhtme është pasqyruar fitimi i realizuar nga viti 2010 – 2015 dhe gjendja e arkës ose vlera e tërhequr nga pronari, sipas pretendimit të subjektit. Të gjitha të dhënat janë marrë nga pasqyrat financiare të dorëzuara në zyrën e tatimeve nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Fitimi i klinikës	2,144,255	2,241,538	2,260,066	2,773,965	4,286,713	4,714,717
Arka/vlera e tërhequr nga pronari	1,453,176	2,936,274	5,184,118	2,918,851	3,730,888	655,710

Në qoftë se arka do të ishte vlera e tërhequr nga pronari, vihet re se pronari tërheq më tepër sesa fitimi real i mikronjesisë, në një kohë kur subjekti pretendon që fitimi i secilit vit është përdorur për shlyerjen e borxheve të marra, këstet e kredisë, si dhe këstet e vilës, pra, është tërhequr e gjithë shuma. Meqenëse subjekti e pretendon një lapsus të hartueses së pasqyrave financiare dhe se ajo në vitin 2016 e ka sistemuar këtë praktikë, përsëri vihen re pasaktësi në hartimin e këtyre pasqyrave financiare, nëse do t'i qëndrojmë variantit të lapsusit. Kjo, për faktin se diferenca mes fitimit të vitit dhe tërheqjeve të kryera nga pronari në fund të vitit fiskal duhet të figurojë në bankë ose në arkë, veprim financiar që nuk rakordon mes fitimit të realizuar, tërheqjeve të kryera dhe gjendjes së raportuar në arkë ose bankë. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, pavarësisht se subjekti është pyetur vazhdimisht nga Komisioni për provueshmërinë e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortes së tij, ai nuk e ka deklaruar asnjëherë këtë sistemim të kryer nga hartuesja e pasqyrave financiare.

Subjekti, me veprimet dhe me mosveprimet e tij, nuk arriti të shpjegojë bindshëm me argumente ligjore, jo vetëm konstatimin e Komisionit për gjendjen e konsiderueshme në arkë, por as edhe pretendimin e tij se kjo gjendje realisht ishte tërheqja e pronarit, për shkak se nuk përputheshin shumat e tërhequra me fitimin e biznesit, i cili rezultonte më i ulët sesa vlerat e tërhequra.

- ✓ Në konkluzion, situatën e analizuar sa më sipër në raport me pretendimin e subjektit se *gjendja në arkë është tërhequr në mënyrë të vazhdueshme*, në vlera të konsiderueshme, trupi gjykues e çmon në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për një paraqitje të pasaktë të burimeve të pasurive në deklaratën “Vetting”, si të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes, me pretendimin për justifikimin e tyre me 13 huat, si dhe për deklarim të pamjaftueshëm të saj, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e analizës financiare

Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratat “Vetting”, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike.

Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për të realizuar kursimet e deklaruara dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁶⁰, dhe djalin⁶¹ e subjektit, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Për të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat, klinika dentare, është marrë në konsideratë:

- korrespondenca e mbajtur me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë⁶², sipas të cilës, që prej ushtrimit të aktivitetit, prill 1994 dhe deri në vitin 2006, nuk disponohen të dhëna lidhur me fitimin *neto* të realizuar, por disponohen të dhëna vetëm mbi qarkullimin dhe taksën e paguar.

Për vitet 2008 – 2016 informacioni i Drejtorisë Rajonale Tatimore është i plotë, pasqyron qarkullimin dhe fitimin *neto* të realizuar nga ky aktivitet, për pasojë, për vitet 2008 – 2016 përlllogaritjet e fitimit *neto* janë lehtësisht të verifikueshme dhe tërësisht në nivel zyrtar.

- Urdhri i Stomatologut ka paraqitur opinion⁶³ me disa argumente, nëpërmjet të cilëve, me rezervë, konfirmon se *marzha e fitimit në masën 85 % mund të justifikohet me faktin që mund të jetë cenuar cilësia dhe standardi duke punuar me materiale të cilësisë më të dobët të mundshme dhe me mungesë të plotë të personelit ndihmës dhe standardit të infrastrukturës në klinikën dentare.*

Për sa sipër, lidhur me vitet 2008 – 2016, Komisioni ka konstatuar se në rastin më të mirë fitimi i të ardhurave mbi qarkullimin ka qenë në masën deri 62 %, ndërsa në tërësi, për pjesën më të madhe të këtyre viteve, ka qenë 42 % deri në 51 %.

Në përgjigje të pyetësorëve është pretenduar se, përveç aktivitetit si stomatologe, bashkëshortja e subjektit ka kryer edhe shërbime të tjera stomatologjike, të cilat nuk janë përfshirë në qarkullimin e pasqyruar nga kjo drejtori, etj.

Këto pretendime kanë mbetur në nivel deklarativ pasi nuk është depozituar ndonjë provë lidhur me përfitimin e të ardhurave nga shërbimet e tjera.

Në arsyetim të të gjitha informacioneve të sipërcituara, Komisioni ka vlerësuar ta analizojë periudhën 1995 – 2007 të ndarë në tri etapa, në përqindje të ndryshme.

- a) Për periudhën 1995 – 1997 analiza është kryer për një normë fitimi prej 75 %, duke vlerësuar: (i) përvojën e bashkëshortes së subjektit, se viti i parë i punës daton në vitin 1988, pra, disa vite më parë se nisja e aktivitetit privat; (ii) faktin që ajo ka nisur një biznes

⁶⁰ Vërtetimet nr. (***) prot., dhe nr. (***) prot., datë 23.1.2017, të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Komanda e Forcës Ajrore, Reparti Ushtarak nr. 3005, dhe vërtetimi nr. (***)prot., datë 7.2.2019, të Komandës së Repartit Ushtarak nr. 3001, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat nr. (***) prot., datë 18.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës nr. (***) prot., datë 18.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nr. (***) prot., datë 28.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Gjykata e Apelit për Krimet të Rënda, nr. (***) prot., datë 23.1.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse nr. (***) prot., datë 25.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nr. (***) prot., datë 23.2.2015, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Komisioni për Vlerësimin e Programit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, nr. (***) prot., datë 18.2.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶¹ Vërtetim nga “ProCredit Bank” datë 23.1.2017 në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Ministria e Drejtësisë nr. (***) prot., datë 25.1.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi – IDRA, datë 24.1.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Instituti i Europës Juglindore për Kontratën Shoqërore (SSCI), datë 24.1.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶² Shkresë nr. (***) prot., datë 7.1.2019.

⁶³ Referuar shkresës nr. (***)prot., datë 15.4.2019, në dosjen e Komisionit.

të ri do të thotë që ka kostot fillestare të investimit; (iii) nuk ka pasur të punësuar të tjerë; (iv) detyrimet tatimore kanë qenë minimale; (v) qyteti i ushtrimit të aktivitetit, Kuçovë, i njohur si një qytet i vogël në popullsi, relativisht me njohje mes njëri-tjetrit; si edhe (vi) fitimin e deklaruar nga subjekti (pra, i vlerësuar në nivel deklarativ, i pambështetur në dokumentacion).

b) Për periudhën 1998 – 2002 analiza është kryer mbi një normë fitimi prej 70 %, duke marrë parasysh: (i) deklarimin e vetë subjektit të rivlerësimit se, që nga janari i vitit 1998 e në vijim, pas asistencës së dhënë nga administrata tatimore, bashkëshortja e tij ka korrigjuar praktikën e deklarimeve; (ii) ekonomia filloi formalizimin e saj⁶⁴; (iii) ka kryer investime për blerje pajisjesh; si dhe (iv) fitimin e deklaruar nga subjekti (pra, i vlerësuar në nivel deklarativ, i pambështetur në dokumentacion).

c) Për, periudhën 2003 – 2007 analiza është kryer mbi një normë fitimi prej 60 %, duke marrë parasysh: (i) zhvendosjen e aktivitetit në Tiranë; (ii) faktin që ajo është vendosur në një treg të ri pune, që kërkon më tepër punë për të fituar klientë; (iii) investimin e kryer për blerjen e një klinike të re (pasuri e paluajtshme); (iv) blerjen e pajisjeve të reja etj.; si dhe (v) fitimin e deklaruar nga subjekti (pra, i vlerësuar në nivel deklarativ, i pambështetur në dokumentacion).

Në të gjitha analizat e pasurive, përqindjet e mundshme të fitimit janë aplikuar mbi qarkullimin që pasqyrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Viti	Qarkullimi	Përqindja e aplikuar	Fitimi neto
1994	nuk ka të dhëna		
1995	95,020	75%	71,265
1996	260,000	75%	195,000
1997	300,000	75%	225,000
1998	1,300,000	70%	910,000
1999	1,407,300	70%	985,110
2000	1,665,000	70%	1,165,500
2001	1,853,000	70%	1,297,100
2002	1,900,000	70%	1,330,000
2003	1,200,000	60%	720,000
2004	1,750,000	60%	1,050,000
2005	3,000,000	60%	1,800,000
2006	5,333,333	60%	3,200,000
2007	6,950,000	60%	4,170,000

Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruar, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën “Vetting”, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Gjithashtu, për periudhën 2008 – 2016, fitimit *neto* që rezulton nga aktiviteti i klinikës i është shtuar edhe shpenzimi i amortizimit të asetëve. Për vitet 2008 – 2016 mungon plani i amortizimit për secilin aset, vite këto për të cilat pretendohet shtesa e vlerës së amortizimit.

Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë sa më poshtë:

- Shpenzimet e jetesës, për vitet 2003 – 2016, u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së. Për vitet 1996 – 2002 shpenzimet u bazuan në pretendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin e datës 11.4.2019, në shumën 10.000 lekë/muaj për familjen e tij,

⁶⁴ Miratuar ligji i tatimit mbi të ardhurat.

dhe për periudhën para vitit 1996, shpenzimet konsiderohen në masën 40 % e të ardhurave, sipas pretendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit në të njëjtin pyetësor.

- Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht, lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratat e subjektit. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat *low cost*, deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Ndërsa, për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja/djali kanë deklaruar udhëtime për qëllime pune.

- Shpenzimet e shkollimit⁶⁵, arredimit u bazuan në deklaratat e subjektit.

- Pagesat e kryera për këstet e kredisë janë bazuar në verifikimin e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

- Detyrimet ndaj huave të ndryshme dhe shlyerja e tyre u bazuan në deklaratat e subjektit të kryera në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore si edhe në dokumentacionin e dorëzuar gjatë hetimit.

Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë:

- deklarimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore;

- bilancet e klinikës dentare, aktivitetet e bashkëshortes, dorëzuar nga subjekti, si dhe informacioni i marrë nga QKB-ja, ku pasqyrohet gjendja në arkë dhe bankë.

Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

➔ Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe prapësimeve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, duke qenë përpara faktit të konfirmuar nga DRT-ja Tiranë se për aktivitetin e bashkëshortes së tij ka pasur vetëm qarkullimin për vitet 1995 – 2006 dhe, për të qenë sa më objektiv me subjektin, hartoi tabelën e re me fitimin e mundshëm sipas marzhës së fitimit të pretenduar nga subjekti.

- Për vitet 2003 – 2007 përlogaritjet janë bërë sipas qarkullimit të konfirmuar nga DRT-ja Tiranë dhe marzhës së fitimit të pretenduar nga subjekti.

- Për vitin 2007 është marrë në konsideratë deklarimi i subjektit dhe në fitimin *neto* (pas aplikimit të përqindjes së marzhës) është shtuar edhe vlera e pajisjes dentare e shitur në shumën 450.000 lekë.

- Për vitet 2009 – 2011 në shumën totale të amortizimit (ndërtesa, pajisje, etj.), që i është shtuar vlerës së fitimit si e ardhur, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë të gjithë vlerën e amortizimit të klinikës. Vihet re se bashkëshortja e subjektit e ka amortizuar klinikën në të gjithë vlerën e saj. Kjo ka sjellë shtim të shpenzimeve në një shumë që nuk i takon dhe, për pasojë, fitim në një vlerë më të ulët dhe më pak pagesë për tatimfitimin. Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm ½ e vlerës së amortizimit të ndërtesës/klinikës, kjo për arsyen sepse bashkëshortja e subjektit është pronare vetëm 50 % e klinikës dhe, si rrjedhim, duhet të amortizojë vetëm pjesën e saj takuese: ½ e vlerës.

⁶⁵ Vërtetim nr. (***) prot., datë 24.10.2016, nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "L.", në dosjen e ILDKPKI-së.

Vërtetim nga Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane, nr. (***) prot., datë 24.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Nga viti 2012 e në vazhdim, amortizimi është pasqyruar saktë në bilanc, vetëm për ½ e vlerës së klinikës, dhe Komisioni për këto vite e ka marrë në konsideratë të gjithë vlerën e pretenduar nga subjekti.

Fitimi *neto* i pasqyruar në tabelën e mëposhtme është përfshirë në analizimin e të gjitha pasurive të lartpërmendura në pikën e titulluar “Vlerësimi i Pasurisë”.

Viti	Qarkullimi	Përqindja e aplikuar	Fitimi neto
1994	nuk ka të dhëna		
1995	95,020	80%	76,016
1996	260,000	80%	208,000
1997	300,000	80%	240,000
1998	1,300,000	75%	975,000
1999	1,407,300	75%	1,055,475
2000	1,665,000	75%	1,248,750
2001	1,853,000	75%	1,389,750
2002	1,900,000	70%	1,330,000
2003	1,200,000	70%	840,000
2004	1,750,000	70%	1,225,000
2005	3,000,000	70%	2,100,000
2006	5,333,333	65%	3,466,666
2007	6,500,000	60%	4,350,000 (3,900,000+450,000)

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. (***) prot., datë 31.10.2017, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, ku ka konstatuar se:

- ✓ Nga hetimi nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016:

DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari.

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ai ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur raportin⁶⁶ e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari.

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në:

- formularin e vetëdeklarimit, tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna dhe dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; dhe
- pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së:
- të dhënat nga burime arkivore të KLD-së;
- aftësitë profesionale;
- aftësitë organizative;
- etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, nga periudha janar 2004 – korrik 2014, ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Në muajin gusht të vitit 2014, ai ka kaluar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, ku vijon edhe aktualisht detyrën.

- Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

1. Vendimi nr. (***), datë 5.10.2015, i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, me kërkues Prokurorinë për Krime të Rënda, kundër të pandehurit M. V.; akuza “*Trafikimi i personave të mitur, neni 110/a/4 i Kodit Penal*”.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore, me relator subjektin e rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 5.10.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 5.10.2015. Në përfundim është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

2. Vendimi nr. (***), datë 20.9.2016 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, me kërkues Prokurorinë për Krime të Rënda, kundër të pandehurve A. D., L. B., A. R.; akuza “*Trafikimi i narkotikëve, kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, neni 283/a, paragrafi 2 dhe 22 i Kodit Penal*”.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike, me relator subjektin e rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 20.9.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 20.9.2016. Në përfundim është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

3. Vendimi nr. (***), datë 24.3.2016 i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, me kërkues Prokurorinë për Krime të Rënda, kundër të pandehurve I. H. dhe A. Z.; akuza “*Shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, neni 109/b paragrafi 1 dhe 25 i Kodit Penal*”, i pandehuri: R. H.; akuza “*Moskallëzim krimi*”.

Çështja është gjykuar në seancë gjyqësore publike, me relator subjektin e rivlerësimit. Seanca është zhvilluar në datën 24.3.2016 dhe vendimi është dhënë në datën 24.3.2016. Në

⁶⁶ Raporti nr. (***) prot., datë 11.3.2019 i KLGJ-së.

përfundim është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me ndryshimin: deklarin *fajtor* të të pandehurit I. H. . Çështja është regjistruar për gjykim në datën 27.11.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 24.3.2016.

- ❖ Subjekti ka paraqitur edhe dokumente të tjera shoqëruese të formularit të vetëvlerësimit, të cilat pasqyrojnë vlerësime profesionale të institucionit punëdhënës: certifikata trajnimi, pjesëmarrjeje, autorësi në botime, anëtarësime etj.

- Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të subjektit Gurali Brahimllari të përzgjedhura me short:

1. *Dosja 1.* Çështja penale nr. (***) regj., datë 17.10.2014, kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kundër të pandehurit K. L., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Trafikim të narkotikëve mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal*”, e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 27.11.2014.

Nga aktet e paraqitura nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë në datën 3.12.2014, **6 ditë nga shpallja** jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga analiza e të dhënave të nxjerra nga vëzhgimi i kësaj çështjeje, konstatohet se gjykimi nga subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, ka zgjatur gjithsej **1 muaj e 7 ditë**, në intervalin kohor 20.10.2014 – 27.11.2014.

2. *Dosja 2.* Çështja adm. penale nr. (***) regj., datë 20.9.2016, që i përket kërkuesit Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kundër të dyshuarit D. Q., për kryerjen e veprës penale të vrasjes së punonjësit të policisë së shtetit etj., me objekt “*Vleftësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit arrest në burg*”, e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 28.9.2016.

Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë në datën 20.9.2016.

✓ Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë paraqitur rekurs.

3. *Dosja 3.* Çështja adm. penale nr. (***) regj., datë 30.12.2015, që i përket kërkuesit Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kundër O. H. (A.), me objekt “*Sekuestrim pasurie bazuar në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 ‘për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’*”, e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 27.1.2016.

Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë në datën 30.12.2015. Me shortin e datës 5.11.2016 ajo i është caktuar trupit gjykues me kryesues subjektin e rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari. Nga Kryesuesi i kolegjit gjykues, në datën 6.1.2016 (1 ditë nga shorti), është marrë vendimi për caktimin e seancës gjyqësore në datën 27.1.2016, ora 11:00.

✓ Ndaj këtij vendimi nuk rezulton të jetë paraqitur rekurs.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, është depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë në datën 29.1.2016, **2 ditë nga shpallja**, brenda afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

4. *Dosja 4.* Çështja penale nr. (***) regj., datë 2.3.2015, kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, që i përket të pandehurve A. A. dhe E. Xh., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, mbetur në*

tentativë, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79/c dhe 22 e 25, të Kodit Penal etj.”, e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 15.5.2015.

Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë në datën 2.3.2015. Me shortin e datës 5.3.2015, çështja i është caktuar si kryesues i trupit gjykues, subjektit të rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari. Nga Kryesuesi i kolegjit gjykues, në datën 6.3.2015 (1 ditë nga shorti), është marrë vendimi për caktimin e seancës gjyqësore në datën 30 mars 2015, ora 9:30.

5. *Dosja 5*. Çështja penale nr. (**) regj., datë 21.6.2013, kërkues Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, kundër të pandehurve Xh. N., B. I., E. H., E. L., J. Z., S. B., B. K., L. A. e D. Q., të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 140-25, 278/2, 279 e 139-25 të Kodit Penal; tre të pandehurit e parë edhe për veprat penale të parashikuara nga nenet 28/4, 333/a e 334 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. (***), datë 9.12.2013.

Mbi rekursin e prokurorit të apelit për krimet e rënda dhe të pandehurve D. Q., L. A., dhe B. K., Gjykata e Lartë, me vendimin nr. (***), datë 28.12.2015, ka vendosur:

- Mospranimin e rekursit të ushtruar e prokurorit të apelit për krimet e rënda dhe të gjykuarit D. Q., L. A. dhe B. K., kundër vendimit nr. (***), datë 25.3.2014, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Nga vendimi i Gjykatës së Lartë, lidhur me vendimin e apelit, rezulton se rekursi i paraqitur nga prokurori i apelit për krime të rënda dhe të gjykuarit D. Q., L. A. e B. K., nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtari Gurali Brahimllari ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 8.7.1994 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2001. Pas studimeve, në datën 2.10.2001, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier deri në datën 23.12.2003, ku është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në vijim, më 30.7.2014 gjyqtari Gurali Brahimllari është emëruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, ku vazhdon edhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Gurali Brahimllari është paraqitur një ankesë (në vitin 2014) në Inspektoratin e KLD-së.

Ankesa e verifikuar, bazuar në informacionin e dërguar nga vetë kryetari për vendimet e cenuara, i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Gurali Brahimllari, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Analiza e gjetjeve

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar dhe në arsyetim i

kushton rëndësi të gjithë elementeve të veprës penale dhe analizës së provave. Zbaton me korrektesë procedurën e gjykimit të shkurtuar, si dhe ka njohuri lidhur me aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim.

- ✓ Nga analiza e tri dokumenteve ligjore dhe e pesë dosjet e përzgjedhura me short, evidentohet se subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e vendimeve, nuk i përdor shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban të gjithë elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural penal.

Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

- ✓ Vërehet se në dosjet 2 dhe 5 nuk është shprehur e drejta e rekursit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Gurali Brahimllari. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Një ankesë e vitit 2014 e verifikuar, bazuar mbi informacionin e dërguar nga vetë kryetari për vendimet e cenuara, i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari. Për vetë gjyqtarin Gurali Brahimllari, në asnjërin prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me konceptin e gjykatës së paanshme.

C/1 Rivlerësimi i aftësisë profesionale

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin:

- e raportit nr. (***) prot., datë 11.3.2019, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Inspektorati i KLGJ-së;

- e denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016;
- e kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).
- Komisioni, nga vlerësimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe i pesë dosjeve të shortuara, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin e tij, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.
- Komisioni, në tërësi, vërejt se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor në vendimmarrjet e tij, si dhe ruan normat etiko-profesionale.
- Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit u paraqitën dy denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, përkatësisht:
 - Denoncimi nr. (***) prot., datë 23.1.2019, i shtetasit A. H. .
Ndër të tjera, denoncuesi, në parashtrimet e tij kërkonte shqyrtimin e diskutimit përfundimtar të prokurores D. H, si dhe të vendimeve të dhëna në shkallë të parë dhe më tej, në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, në të cilin subjekti i rivlerësimit rezultoi se kishte pasur cilësinë e anëtarit të trupës gjyqësore.
 - Denoncimi nr. (***) prot., datë 3.8.2018 i shtetasit M. H. (dedektiv privat) me cilësinë e administratorit të Agjencisë (***), Tiranë.
Ndër të tjera, denoncuesi, me cilësinë e detektivit privat (pasi ka investiguar për çështjen objekt denoncimi) ankohej ndaj një vendimmarrjeje të padrejtë të dhënë ndaj të pandehurit Sh. L. .
- Nga shqyrtimi i parashtrimeve në denoncime, si dhe nga dokumentacioni i administruar, u vërejt se nuk rezultuan shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.
- ✓ Për të gjitha shkaqet dhe arsyet e sipërpërmendura, trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të grupit të punës, fakteve publike, denoncimeve, nuk gjeti indice, apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale dhe, pas rekomandimit të relatores së çështjes, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për rivlerësimin e pasurisë, konkludohet se subjekti i rivlerësimit:

- 1.** Për pasuritë e krijuara përpara vitit 2003, ka mungesë të të ardhurave në shumën 951.756 lekë, për të justifikuar:
 - i. blerjen dhe ndërtimin e pasurisë nr. 1 në vitet 1997 – 1998, si dhe ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën e shpenzuar për ndërtimin e pasurisë shtesë me sip. 16 m²;
 - ii. investimin në pasurinë nr. 2 në vitin 2000;
 - iii. ndërtimin e klinikës dentare në qytetin e Kuçovës në vitin 1995, si dhe ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj klinike.
- 2.** Ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 1.500.000 lekë (dhënë hua nga shtetasi A. S.), sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ka mungesë dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 19.000 euro (dhënë hua nga shtetasi A. S.), sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

4. Nuk arriti të shpjegojë bindshëm, sipas nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, burimin e ligjshëm të shumës 2.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi B. B. .

5. Për pasurinë nr. 4:

- i. ka mungesë të të ardhurave në shumën 899.670 lekë për të justifikuar pagesën e shumës 49.000 euro në vitin 2008;
- ii. nuk ka deklaruar këstin e paguar në datën 18.10.2008, në shumën 10.000 euro;
- iii. nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën prej 6.536 euro sipas pretendimit të tij se ka paguar shumën 20.000 euro në fund të muajit dhjetor të vitit 2008, si dhe nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.291.185 lekë, të pretenduar në tabelën e përlllogaritjeve nga eksperti kontabël, po për vitin 2008.
- iv. ka mungesë të të ardhurave në shumën 2.172.082 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 41.000 euro deri në datën 3.6.2009;
- v. ka kryer deklarim të rremë lidhur me burimin e krijimit të këstit prej 41.000 euro në vitin 2009, pasi ka deklaruar si burim krijimi të tij dy hua të marra përtej shlyerjes, përkatësisht në shumën 1.000.000 lekë, marrë shtetasit P. B., në datën 14.8.2009 dhe 10.000 euro marrë shtetasit B. B., në datën 17 shtator të po këtij viti.
- vi. nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1.291.185 lekë, të pretenduar në tabelën e përlllogaritjeve nga eksperti kontabël të vitit 2008 mbartur për shpenzimet e gjashtë mujorit të parë për vitin 2009.
- vii. nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të shumës 10.000 euro marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi B. B. në 14.8.2009, sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.
- viii. nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të shumës 1.000.000 lekë, marrë hua nga vëllai i tij, shtetasi P. B., në gusht të vitit 2009, sipas pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.
- ix. ka mungesë të të ardhurave në shumën 9.912.391 lekë (nga të cilat 6.840.639 lekë për vitet 2008 – 2016 dhe 3.071.752 lekë për këstet deri në tetor të vitit 2008 dhe qershor të vitit 2009) për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, për shlyerjen e huave të marra, kësteve të kredive në shumën 25.000 euro dhe 50.000 euro, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të familjes së tij, përgjatë viteve 2008 – 2016;

6. Ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën “Vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre dhe të të ardhurave me burim nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortes për justifikimin e 13 huave, sipas pikave 1, 3, dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklarim të pamjaftueshëm sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar nenet 179/b, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gurali Brahimllari, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland Ilia
Kryesues

Brunilda Bekteshi
Relatore

Genta Tafa (Bungo)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta